

Trajnim rajonal për mësues të shkollave fillore në Ballkanin
Perëndimor – Trajtimi i Diskriminimit në Klasë
(dokument pune)



BEST PRACTICES
for
ROMA INTEGRATION
in the Western Balkans

Përgatitur nga Ruth Friedman



Funded by the EU

Trajnim rajonal për mësues të
shkollave fillore në Ballkanin
Perëndimor – Trajtimi
i Diskriminimit në Klasë
(dokument pune)

Detaje të publikimit:
Shkruar në shtator 2013

Autor:
Ruth Friedman

Dizenjimi:
comma | communications design

Ky publikim është bërë nga autori me mbështetjen e projektit Praktikrat më të Mira për Integrimin e Romëve (PMIR). Publikimi është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit PMIR, zbatuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian, as politikat dhe pozicionin e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).

Trajnim rajonal për mësues të shkollave fillore në Ballkanin Perëndimor – Trajtimi i Diskriminimit në Klasë (dokument pune)

Përgatitur nga Ruth Friedman
për
Projektin “Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve”
Realizuar nga
OSBE-ODIHR
Financuar nga BE/Shtetet pjesëmarrëse



Ruth Friedman

Ruth ka punuar me çështjet e mos-diskriminimit dhe dialogut ndërkulturor që prej vitit 2007. Më parë ajo ka punuar në CEJI, duke bashkërenduar dhe drejtuar Programin e Trajnimeve për Diversitetet Fetar dhe Anti-Diskriminim. Gjithashtu, ajo ka përvojë të gjatë me mësues në nivel lokal, duke realizuar programe kombëtare në tërë rajonin, për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës, çështje mjedisore, dhe të qëndrueshmërisë. Aktualisht, ajo punon si konsulente dhe trajnuese.

Falënderime

Dua t'u shpreh mirënjohje për frymëzimin, inkurajimin dhe përkrahjen e tyre në shkrimin e këtij udhëzuesi për trajnime: Kristin Neff, Christopher Germer, Meru Wray, Jarmila Bujak Stanko, Judith Kiers dhe të gjithë pjesëmarrësve në Takimin e Grupit të Fokosit në Budapest.

Të gjitha pohimet dhe idetë e pasqyruara në këtë udhëzues i përkasin autorit, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e organizatës.

Ky udhëzues për mësues është përgatitur nga autorja, me ndihmën e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR).

Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit Praktikë më të Mira për Integrimin e Romëve, dhe zbatuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR).

Qëndrimet e shprehura në këtë udhëzues janë të autores dhe nuk mund të merren si pasqyrim i qëndrimit zyrtar të Bashkimit Evropian, dhe as nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën dhe qëndrimet e ODIHR-it.

Përmbajtja

PJESA A – hyrje dhe formësimi i trajnimit	11
1. Hyrje në trajnim	11
a) Qasja pedagogjike	12
b) Pasqyra e kurrikulës	14
c) Shembuj për Programin e Trajnimit	15
2. Hyrje – Loja me emra	18
3. Të mësuarit për grupin dhe njëri-tjetrin	19
a) Të përbashkëtat	19
b) Autografi	20
4. Ngjashmëritë dhe dallimet	23
5. Pritshmëritë, nevojat dhe rregullat bazë	25
PJESA B – Konceptet	27
6. Kuptimi se çfarë është diskriminimi	28
Mos gjyko se çfarë ka në kuti nisor nga mbështjellësja e saj	28
7. Identiteti dhe diversiteti	32
a) Identitetet e ndryshme	32
b) Shkëmbim idesh për diversitetin	34
8. Veçantia dhe humaniteti	35
a) Duart sekrete	35
b) Marrje e ideve lidhur me aspektet e përbashkëta njerëzore	39
9. Krijimi i një mjedisi respekti për të gjithë	40
a) Vlerësimi i vetes dhe e njëri-tjetrit	40
b) Receta e respektit	42
PJESA C – ndikimet	45
10. Përjetimi i diskriminimit	45
11. Plotësimi i pritjeve	45

PJESA D - mjetet	49	
12. Përdorimi i tregimeve në luftën kundër diskriminimit		49
13. Trajtimi i diskriminimit dhe ngacmimit në klasë	51	
14. Përmirësimi i imazhit/vetërespektit për të gjithë fëmijët		58
a) Përdorimi i artit si mjet për luftimin e diskriminimit		58
b) Ditari i mirënjohjes	62	
c) Në klasën tonë	63	
d) Të ndihmoheshokët	65	

PJESA E - sesioni mbyllës	69	
15. Planifikimi	69	
a) Planifikimi i veprimeve	69	
b) Detyrë shtëpie dhe vazhdimi	70	
16. Aktivitete mbyllëse	71	
a) Urimet më të mira	71	
b) Kaloje gurin tek tjetri	72	
c) Përfundimet	73	

Shtojca 1 - informacion mbështetës në lidhje me diskriminimin e romëve	75
---	-----------

Shtojca 2 - modul i fokusuar tek romët	85
Moduli I: Identiteti dhe Kultura	86
Moduli II: Prindërit romë dhe fëmijët e përfshirë	91
Moduli III: Sygjerime se si të reagohet ndaj situatave sfiduese	92

Udhëzues për trajnim – Trajtimi i diskriminimit në klasë (dokument pune)

PJESA A

Hyrje dhe formësimi i trajnimit

1. Hyrje në trajnim

Ky udhëzues trajnimi është hartuar në kuadër të projektit Praktikrat më të Mira për Integrimin e Romëve, projekt i financuar nga BE-ja, e zbatuar nga OSBE-ODIHR-i, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe qasjes në të drejta për komunitetet rome në Ballkanin Perëndimor. Ky udhëzues për trajnim është hartuar për mësuesit e shkollës fillore në rajon, për t'i përkrahur në parandalimin dhe reagimin ndaj diskriminimit të romëve dhe grupeve të tjera pakicë në klasë.

Ky manual trajnimi duhet të konsiderohet si një dokument pune. Ai është një përmbledhje e materialeve që u përdorën në trajnimin e organizuar në kuadrin e programit të OSBE-ODIHR-it Praktikrat më të Mira për Integrimin e Romëve, që u zhvillua në Tiranë në gusht 2012, ku ato u përdorën si pilot. Ky manual nuk duhet të përdoret pa marrë trajnimin e duhur.

Qasja e këtij udhëzuesi është t'i përkrahë mësuesit të punojnë në mënyrë që të përfshijnë të gjithë nxënësit, si dhe të krijojnë një mjedis ku pikat e përbashkëta të njihen dhe të afirmohen. Ky udhëzues i kushton rëndësi faktit që secili është pjesëtar i grupit të quajtur "njerëzim", përtej të gjitha dallimeve që mund të ekzis-

tojnë mes grupeve. Njëkohësisht, trajnimi do të nxisë dhe mirëpresë diversitetin që ekziston brenda cilitdo grup, në dobi të të gjithë grupit.

Qëllimi i këtij trajnimi është të ndihmojë pjesëmarrësit që të jenë më përfshirës për të gjithë njerëzit me të cilët punojnë, pa marrë parasysh etninë, fenë, moshën, gjininë, orientimin seksual, kombësinë, aftësitë fizike dhe mendore, apo aftësitë e kufizuara, apo cilëndo kategori tjetër që mund të përdoret për ndarjen e njerëzve. Trajnimi synon t'i ndihmojë pjesëmarrësit të krijojnë dhe përkrahin hapësira mësimi që i mirëpresin të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh përkatësitë e tyre.

a) *Qasja pedagogjike*

Ky udhëzues trajnimi është hartuar për mësuesit në shkollat fillore. Ai synon që mësuesit vetë të provojnë aktivitetet dhe, duke bërë këtë, të bëjnë aktivitete individuale dhe t'i shfrytëzojnë drejtpërdrejt me fëmijët në klasë, pa patur shumë nevojë për përshtatje për fëmijët. Përveç këtyre, në tekst janë futur disa aktivitete "vetëm për mësues", për t'i ndihmuar mësuesit që t'i kuptojnë më thellë konceptet, aty ku është e domosdoshme. Gjatë trajnimit të mësuesve pas ushtrimeve, do të ketë kohë për të diskutuar konceptet pedagogjike dhe arsyet që i mbështesin këto koncepte.

Qëllimet dhe rezultatet mësimore që priten prej këtij trajnimi përkufizohen si në vijim:

Qëllimet:

- Rritja e vetëdijes dhe të kuptuarit të diskriminimit dhe paragjytimeve që ndikojnë në arsimimin e fëmijëve në shkollën fillore.
- Rritja e të kuptuarit të çështjeve që kanë ndikim te romët dhe fëmijët e tjerë nga pakicat, si dhe te familjet e tyre.
- Rritja e të kuptuarit e ndikimit të paragjykimit, ngacmimeve dhe diskriminimit në klasë.
- Zhvillimi i aftësive dhe teknikave të mësuesve për të sfiduar dhe trajtuar të gjitha trajtat e diskriminimit dhe paragjykimeve, të cilat manifestohen në klasë.
- Krijimi i një hapësire miqësore e të sigurt për të gjithë fëmijët.

Rezultatet e dëshiruara mësimore:

- Të mësohet se si të krijohen mjedise pozitive e respektuese mësimore për të gjithë fëmijët.
- Të kuptohet ndikimi negativ që mund të ketë diskriminimi tek fëmijët e pakicave.
- Të ndërtohet një repertor aktivitetesh për të trajtuar paragjykimet dhe diskriminimet tek fëmijët.

Ky trajnim synon të jetë pjesëmarrës dhe të ofrojë përvojën; pjesëmarrësit inkurajohen të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aktivitetet, aty ku është e mundur. Pjesëmarrësit nuk duhet të detyrohen të bëjnë ndonjë gjë me të cilën nuk ndjehen rehat, por duhen inkurajuar të eksperimentojnë me metoda mësimore që janë të reja dhe sfiduese për ta.

Aktivitetet përfshijnë diskutime në grupe të mëdha, punë në grupe të vogla, aktivitete në dyshe, dhe punë individuale. Disa prej aktiviteteve nxisin kreativitetin e brendshëm të të gjithë njerëzve, gjë që është shumë e gjallë tek fëmijët, ndërsa kjo përdoret në aktivitete për të ndihmuar të nxënit në mënyrë që duket më pak intelektuale. Ushtrimet ndërvepruese janë të përshtatshme për t'u përdorur me fëmijët dhe janë dhënë si mjete për të zhvilluar vetëdijen, qëndrimet pozitive, dhembshurinë për të tjerët, si dhe kapacitetin për zgjerimin e këndvështrimit. Diskutimet në grup synojnë të krijojnë qëndrime konstruktive për të gjetur zgjidhje të reja. Ushtrimet "vetëm për mësues" mundësojnë trajtim më të thellë të temave më komplekse, në mënyrë që mësuesit t'i mund të kuptojnë më mirë këto çështje. Këto aktivitete mund të përshtaten nga mësuesit edhe për t'u përdorur në klasë.

Ushtrimet kreative dhe ushtrimet e tjera që krijojnë përvoja mbështeten nga shpjegimet konceptuale. Të dy komponentët janë të nevojshëm për të siguruar mësimnxënien në mënyrë të integruar.

Në fund të secilit modul të shpjeguar, do të ketë mundësi për të bërë pyetje dhe për të qartësuar qasjen pedagogjike që është përdorur. Kjo ofrohet për të avancuar përvojat e pjesëmarrësve, si dhe për të rritur potencialin për ta sjellë e shfrytëzuar në klasë.

Materialet janë hartuar në mënyrë të tillë që aktivitetet individuale të mund të përdoren drejtpërdrejt në klasë, pa strukturat ekzistuese të kurrikulës. Gjithashtu, pjesë të veçanta të kurrikulës mund të bashkohen për trajnim një apo dy-ditor, ose drejtpërdrejt me fëmijë ose me mësuesit e tyre.

b) Pasqyra e kurrikulës

Kurrikula përbëhet nga gjashtëmbëdhjetë module të ndara në pesë pjesë, si në vijim:

Pjesa A - Hyrje

Kjo pjesë fillon me këtë modul dhe ofron një pasqyrë të të gjithë trajnimit, duke shpjeguar qasjen pedagogjike që përdoret në të. Modulet e tjera në këtë pjesë fokusohen në aktivitete nxemjeje, në mënyrë që pjesëtarët e një grupi të ri të mund të njihen me njeri tjetrin. Gjithashtu, aktivitetet paraqesin temat e diversitetit dhe të përbashkëtat e njerëzimit, të cilat janë koncepte themelore të integruara brenda të gjithë trajnimit. Moduli i fundit i kësaj pjese ka të bëjë me identifikimin e nevojave dhe pritjeve të pjesëmarrësve, si dhe diskutimin dhe rënien dakord për disa rregulla bazë për pjesën tjetër të trajnimit. Moduli është vendosur në fund të pjesës hyrëse – pasi grupi të jetë përgatitur dhe para se të fillojë vetë thelbi i trajnimit.

Pjesa B - Konceptet

Kjo pjesë paraqet konceptet themelore që përdoren në trajnim.

Moduli i parë në këtë pjesë paraqet konceptet e Diskriminimit, Paragjykitimit e Stereotipeve, në një mënyrë që është e afërt për fëmijët. Modulet e tjera trajtojnë Identitetin dhe Diversitetin, dhe më pas Veçantitë dhe të Përbashkëtat e Njerëzimit. Këto koncepte janë vetë thelbi i trajnimit – mesazhi kryesor që duhet transmetuar është që, pa marrë parasysh se cila është etnia, prapavija kulturore, feja, etj., secili i përket një race të vetme njerëzore. Moduli përfundimtar ka të bëjë me krijimin e mjedisit respektues për të gjithë.

Pjesa C - Ndikimet

Kjo pjesë po rishikohet. Aktualisht, kjo pjesë përmban një ushtrim i cili tregon ndikimin e mesazheve të marra pozitive dhe negative. Pritet që të ketë aktivitete të tjera shpesh në këtë pjesë, të cilat do të ofronin mundësinë që pjesëmarrësit të provojnë diskriminimin kundër tyre, për të kuptuar së brendshmi përjetimet e një fëmijë nga pakicat, i cili e vuan një përvojë të tillë çdo ditë. Shpresohet që aktivitetet të tilla t'i inkurajojnë mësuesit dhe fëmijët të bëjnë zgjedhje ndryshe, si rezultat i këtyre përvojave.

Pjesa D - Mjetet

Pasi të kenë kuptuar dëmin që mund të sjellë diskriminimi, kjo pjesë ofron mjetet që mund të përdoren për të tejkaluar diskriminimin dhe për t'iu kundërvënë ndikimit të tij. Fokusi është te aktivitetet që janë të dobishme për të gjithë – fëmijët nga pakicat si dhe fëmijët e tjerë. Ekzistojnë tre module. I pari tregon se si mund

të përdoret tregimi për të përçar mesazhe pozitive dhe mund të përdoret drejt-përdrejt me fëmijët. Moduli i dytë është vetëm për mësuesit dhe i ndihmon ata të kuptojnë dallimin mes një personi që ka sjellje sfiduese dhe vetë sjelljes. Moduli i tretë në këtë pjesë paraqet katër aktivitete të ndryshme për të ndërtuar vetëvlerësimin pozitiv; të gjitha aktivitetet mund të përdoren drejtpërdrejt me fëmijët.

Pjesa E - Përmbyllja

Kjo pjesë përmbyllëse ofron mundësi për të reflektuar mbi përvojën e trajnimit, si dhe për të planifikuar hapat që mund të ndërmerren nga pjesëmarrësit për të zbatuar ndryshimet në mjedisin e tyre. Kjo pasohet nga një modul me tri aktivitete, të cilat janë të përshtatshme për përmbyllje.

c) *Shembuj për Programin e Trajnimit*

Shembull 1 Trajnim një ditë e gjysmë

PJESA A - HYRJE

Hyrje në trajnim	Moduli 1	10 min
Loja me emra	Moduli 2	5 - 10 min
Ngjashmëri e dallime	Moduli 4	20 min
Rregullat bazë	Moduli 5	15 – 30 min
Pyetje për pedagogjinë PJESA 1	(sipas nevojës)	10 min

PUSHIM

PJESA B - KONCEPTET

Të kuptuarit e diskriminimit	Moduli 6	40 – 50 min
Stuhi idesh për diversitetin	Moduli 7 a)	15 - 20 min
Të Përbashkëtat e Njerëzimi		
a) Duart e fshehta	Moduli 8 a)	30 - 45 min

DREKA

Rishikimi i pedagogjisë		10 min
Receta e respektit	Moduli 9 b)	40 min

PJESA C - NDIKIMET

Përmbushja e pritshmërive	Moduli 11	60 min
Rishikimi i pedagogjisë		10 min

PUSHIM

Të provuarit të diskriminimit	Moduli 10 a)	50 min
	Ose b)	30 – 40 min
Rishikimi i pedagogjisë		10 min

Dita 2

PJESA D - MJETET

Shfrytëzimi i artit për të luftuar diskriminimin	Moduli 13	60 min
Përmirësimi i vetëvlerësimit/imazhit të vetes		
Ditari i mirënjohjes	Moduli 14 a)	10 - 15 min

PUSHIM

Në klasën tonë	Moduli 14 b)	30 min
Ndihma për shokë	Moduli 14 c)	30 min
Rishikimi i pedagogjisë		10 min

PJESA E - PËRMBYLLJA

Aktivitetet e planifikimit	Moduli 15 a i b)	20 - 40 min
Aktivitet përmbyllës – gjuaj gurin	Ose Moduli 16 c)	30 min
Përfundimet	Moduli 16 c)	10 min

Shembull 2: Trajnim njëditor

PJESA A - HYRJE

Hyrje në trajnim	Moduli 1	10 min
Loja me emra	Moduli 2	5 - 10 min
Ngjashmëri e dallime	Moduli 4	20 min
Rregullat bazë	Moduli 5	15 – 30 min
Rishikimi i pedagogjisë PJESA 1	(sipas nevojës)	10 min

PJESA B - KONCEPTET

Të kuptuarit e diskriminimit	Moduli 6	50 min
Rishikimi i pedagogjisë		10 min
Stuhi idesh për diversitetin	Moduli 7 a)	15 - 20 min
Të Përbashkëtat e Njerëzimit a) duart e fshehta	Moduli 8 a)	30 - 45 min
Rishikimi i pedagogjisë		10 - 15 min

DREKA

Receta e respektit	Moduli 9 b)	30 min
--------------------	-------------	--------

PJESA C - NDIKIMET

Përmbushja e pritjeve	Moduli 11	60 min
Rishikimi i pedagogjisë		10 min

PUSHIM

PJESA D - MJETET

Përmirësimi i vetëvlerësimit/imazhit të vetes		
Ditari i mirënjohjes	Moduli 14 a)	10 - 15 min
Në klasën tonë	Moduli 14 b)	30 min
Rishikimi i pedagogjisë		10 min

PJESA E - PËRMBYLLJA

Aktivitetet e planifikimit	Moduli 15 a dhe b)	20 - 30 min
Aktivitet përmbyllës - përfundimet	Moduli 16 c)	10 min

Parakushtet dhe çështje praktike

Aktivitetet e pasqyruara në këtë udhëzues kërkojnë hapësirë për lëvizjen e pjesë-marrësve në të- në rastet ku ofrohet me përkthim, është e domosdoshme që të përdoren pajisje të lëvizshme, në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të kenë përkthim ndërsa lëvizin. Hapësira duhet të jetë mjaftueshëm e madhe në mënyrë që grupet e vogla të mund të punojnë bashkë në të njëjtën hapësirë- nëse hapësira nuk është e madhe, atëherë mund të nevojiten dhoma shtesë. Është e domosdoshme që hapësira të jetë e tillë ku të mund të vendosen postera të mëdhenj.

Është me rëndësi që pjesëmarrësit në trajnim të marrin pjesë për të gjithë seancën e trajnimit, pasi vijueshmëria e pjesësme e disa pjesëmarrësve mund të sjellë çrregullime te dinamika e grupit, dhe mund të ndikojnë në mësimnxënien e pjesëmarrësve të tjerë dhe grupit në përgjithësi. Pra, vijimi i pjesësme duhet dekurajuar fuqimisht.

Gjithashtu, është mirë të theksohet që përfshirja në mënyrë pjesëmarrëse e ndërvepruese mund të jetë mënyrë e re për disa pjesëmarrës, të cilëve mund t'u nevojitet pak kohë për t'u mësuar me këtë mënyrë.

2. Hyrje – Loja me emra

Arsyetimi: Njohja e emrave të njëri-tjetrit është me rëndësi që grupi të shkrihet në një, ndërsa pjesëmarrësit hapen me njëri-tjetrin. Ky është aktivitet i lehtë e argëtues, duke i ndihmuar pjesëtarësit të krijojnë qëndrimin e duhur për këtë trajnim.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Mësohen emrat e të gjithë pjesëmarrësve në grup
- Zhvillohen aftësi koordinimi
- Ndërtohet ndjenja e përkatësisë në grup dhe e punës së përbashkët

Të nevojshme: Hapësirë ku mund të qëndrojnë në këmbë. Një apo më shumë topa të butë.

Koha: 10 min

Udhëzime:

1. Të shpjegohet që ky aktivitet i thjeshtë do ta ndihmojë grupin të mësojë emrat e secilit.
2. Topi i butë hidhet tek njëri prej pjesëmarrësve, dhe thuhet emri i atij që e hedh topin.
3. I thuhet pjesëmarrësit ta hedhë topin tek dikush tjetër, ndërsa thotë emrin e vet.
4. Ky proces duhet të vazhdojë derisa secili pjesëmarrës ta ketë kapur dhe hedhur topin vetëm një herë. Topi duhet të kthehet tek udhëheqësi i grupit, pasi topin ta kenë kapur një herë që të gjithë pjesëmarrësit.
5. Përsëritet së paku një herë, në mënyrë që secili të dijë rendin e hedhjes dhe kapjes së topit.
6. Tani përsëritet po personi që e hedh topin thërret emrin e personit që duhet ta presë topin. Kështu me radhë.

7. Nëse premtan koha, i mundësohet grupit të krijojë një rend të ri të hedhjes së topit, ku hedhësi thërret emrin e personit tek i cili e hedh topin, apo të shtohen topa të tjerë, duke hedhur e pritur disa topa njëkohësisht.

3. Të mësuarit për grupin dhe njëri-tjetrin

Aktivitetet në këtë modul prezantohen për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të njohin njëri-tjetrin, si dhe për t'u mundësuar të ndjehen mirë me njëri-tjetrin. Këtu ofrohen tri aktivitete alternative. Rekomandohet shfrytëzimi i njërit ose disa prej tyre.

a) *Të përbashkëtat*

Arsyetimi: Ky është aktivitet i thjeshtë informues, për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të relaksohen dhe të gjejnë gjëra të përbashkëta me njëri-tjetrin.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Identifikimi i gjërave të përbashkëta me të tjerët, duke përfshirë ata që besonin të ishin shumë ndryshe nga ju
- Të jemi të hapur të takojmë të tjerët në mënyra të reja

Shënim: Kur përdoret në klasë me etni të ndryshme, bëhen pyetje që kanë gjasë t'i përafrojnë etnitë e ndryshme, e jo pyetje që kanë gjasë t'i ndajnë sipas përkatësisë etnike.

Koha: 15 min

Të nevojshme: Hapësira për të lëvizur.

Udhëzime:

1. Secili të ngrihet në këmbë dhe të lëvizë. Tregojini grupit se duhet të gjejnë personin që ka të njëjtën përgjigje në pyetjet tuaja.
2. Tani thërrisni secilën kategori. Lejoni pak kohë që pjesëmarrësit të gjejnë partnerin.

Disa shembuj:

I njëjti numër i vëllezërve e motrave
I njëjti emision televiziv i preferuar
E njëjta fe
Është lindur në të njëjtin qytet apo qytezë
Ka të njëjtë ngjyrë të preferuar
Ka të njëjtën lodër apo lojë të preferuar
Ka të njëjtin yll të preferuar popi

Etj.

Sigurohuni që të theksoni që të gjejnë një partner në rastet kur është e mundur – aktiviteti nuk synon të përafrojë një numër të madh njerëzish së bashku, por që të theksojë që edhe dikush tjetër në sallë ka të njëjtën ngjyrë të preferuar. Për secilën pyetje duhet të gjejnë një partner të ri (kur është e mundur), në mënyrë që të takojnë sa më shumë njerëz të rinj e të ndryshëm.

3. Në fund të aktivitetit, grupi mund të mblidhet prapë bashkë, dhe t'i pyesni se çfarë kanë mësuar. A janë befasuar nga njerëzit me të cilët kanë patur të përbashkëta? Çfarë kanë mësuar?

b) *Autografi*

Arsyetimi: Si aktivitet alternativ, mund të ndihmohen njerëzit të njohin njëri-tjetrin dhe të kuptojnë që shpesh ka gjëra që nuk dimë për njëri-tjetrin apo nuk i imagjinojmë që të tjerët i kanë. Ky aktivitet ofron mundësi që pjesëmarrësit të flasin kokë më kokë, si dhe të mësojnë më shumë për njëri-tjetrin në këtë mënyrë sesa në një grup të madh.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të zhvillohen aftësitë komunikuese kokë më kokë
- Të fitohet më shumë informacion për pjesëmarrësit e tjerë, të cilët paraqesin edhe diversitet edhe shkëmbim përvojash

Të nevojshme: Karta autografi. Lapsa ose lapustila.

Koha: 15 min

Udhëzime:

1. Të informohen pjesëmarrësit që ky është ushtrim informues, i cili i ndihmon të njohin njëri-tjetrin. Objekti i këtij ushtrimi është të gjenden njerëz të tjerë në sallë që kanë pasur përvoja të ngjashme me ato që janë dhënë në kartat e autografit. Shpërndani kartat dhe kërkojuni pjesëmarrësve të lëvizin nëpër sallë për të takuar njëri-tjetrin. Ata duhet të kërkojnë njerëz që mund të përgjigjen ndaj pyetjeve në kartë. Pasi të gjejnë dikë që mund të japë përgjigje për pyetjen, ai/ajo duhet të nënshkruajë në kartë. Secili person duhet të nënshkruajë vetëm një herë në kartë. Pas 10 minutash, ndalet aktiviteti dhe bëhet pyetja se kush ka mbledhur më shumë përgjigje.
2. Bashkohet prapë grupi dhe pyetet nëse janë befasuar për ndonjë gjë, si dhe nëse kanë mësuar ndonjë gjë interesante për pjesëtarët e tjerë të grupit?

Shënime:

1. Nëse ushtrimi bëhet me fëmijë që nuk dinë akoma të shkruajnë, secili në grup mund të nënshkruajë me ngjyrën apo vizatimin e preferuar.
2. Kur përdoret me fëmijë, aktiviteti mund të zgjerohet duke u kërkuar të flasin me njëri-tjetrin për ndonjë përvojë interesante. Fëmijët mund ta prezantojnë pastaj njëri-tjetrin para të gjithë grupit. Kjo do t'i ndihmojë fëmijët të zhvillojnë aftësi komunikimi.
3. Ky aktivitet funksionon mjaft mirë si nxitës i energjisë. Mësuesit mund ta njohin këtë ushtrim si 'Bingo energji'. Vendi i tij në këtë trajnim nuk është vetëm si nxitës i energjisë, por edhe si mënyrë për të mësuar për diversitetin e përvojave në grup.

Karta

Gjeni dikë që:

Ka flokë ngjyrë kafe

Ka jetuar në një vend tjetër

Ka parë televizor mbrëmë

Flet më shumë se një gjuhë

Nuk i ka takuar kurrë të gjithë gjyshërit

I pëlqen të luajë futboll

Jeton me vetëm një prind

Është fëmijë i vetëm

I pëlqen të këndojë

Ka vëlla apo motër në këtë shkollë

I pëlqen ngjyra e verdhë

Autografi

4. Ngjashmëritë dhe dallimet

Arsyetimi: Gjatë trajnimit në përgjithësi, pjesëmarrësit do të mësojnë të pranojnë të tjerët që janë ndryshe nga ata. Ky aktivitet ndihmon të vendosen bazat, duke i ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë që kanë shumë gjëra të përbashkëta me shumë të tjerë – edhe me njerëzit që i perceptojnë të jenë ndryshe nga ata. Ky aktivitet praktik i demonstroi të dyja këto, në mënyrë argëtuese dhe ndërvepruese.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të mësohet për dallimet dhe gjërat e përbashkëta
- Të kuptohet që shpesh kemi shumë më shumë gjëra të përbashkëta me të tjerët nga sa do të mund ta besonim.

Të nevojshme: Një rreth me karrike

Koha: 15 - 20 min

Udhëzime:

1. Të shpjegohet që ky aktivitet do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të mësojnë që kemi shumë gjëra të përbashkëta, por edhe që ka shumë dallime midis njerëzve. Duke bërë pyetje, kemi mundësi të gjejmë disa prej këtyre gjërave.
2. Duhet të formoni grupin me një rreth karrikesh, ku nuk duhet të ketë karrike të zbrazëta, ndërsa ju si moderator qëndroni në mesin e rrethit. Tregojini grupit që do të luajmë një lojë, si dhe që ju do të paraqisni temën – ndërsa njerëzit që kanë këtë temë të përbashkët duhet të ndërrojnë karriget. Për shembull – “të gjithë që kanë sy të kaltër”. Të gjithë që kanë sy të kaltër duhet të ngrihen dhe të gjejnë një karrike tjetër në rreth.
3. Fillojeni lojën. Tregojeni shembullin:
 - Të gjithë që kanë sy të kaltër

Secili që ka sy të kaltër duhet të ngrihet dhe të ndërrojë karriket me dikë tjetër që është ngritur.

Pastaj merr shembuj të tjerë:

- Të gjithë që janë mësues
- Të gjithë që pijnë duhan
- Të gjithë që i përkasin një grupi pakicë
- Të gjithë që kanë fëmijë nga pakicat në klasë
- Të gjithë që flasin anglisht (apo gjuhë të tjera të trajnimit)
- Të gjithë që jetojnë në një qytet tjetër nga ai ku kanë lindur
- Të gjithë që preferojnë ngjyrën vjollcë
- Të gjithë që janë fjalosur me vëllain apo motrën ndonjëherë
- Të gjithë që nganjëherë hidhërohen me njerëzit që i duan – nënën apo babanë
- Të gjithë që janë lënduar ndonjëherë nga dikush që e duan
- Të gjithë ata që janë lënduar nga diçka që iu është thënë. (5 min)

4. Pas disa minutash, mund ta bëni lojën edhe më interesante dhe të krijoni mundësinë që pjesëmarrësit të shtrojnë pyetje. Kur të shtroni pyetje herën tjetër, uluni në njërin nga karriket dhe dilni nga mesi i rrethit – në mënyrë që njëri nga pjesëmarrësit të mbetet në mes të rrethit. Ky person pastaj e shtron pyetjen tjetër për grupin. (5 -10 min)

(Si trajner keni gjithmonë mundësinë të merrni përsipër dhe të shtroni pyetje sërish duke qëndruar në mes të rrethit).

5. Kontrolloni grupin (5 min)
- Pyetni se çfarë kanë mësuar për njëri-tjetrin dhe për veten e tyre?
 - Pyetni grupin nëse janë befasuar me ndonjë gjë?
 - Pyetni nëse mendojnë se kanë më shumë gjëra të përbashkëta me njëri-tjetrin apo më shumë gjëra që i bëjnë të ndihen të ndryshëm?
 - Si të bën të ndihesh kur gati të gjithë të tjerët duhet t'i ndërrojnë vendet kurse ti jo?
 - Cilat lloje të dallimeve dhe ngjashmërive i përjetoni në jetën e përditshme?

5. Pritshmëritë, nevojat dhe rregullat bazë

Arsyetimi: Qëllimi i këtij aktiviteti është që grupi të mësojë informacione themelore për njëri-tjetrin dhe të ndërtojë një hapësirë të sigurt për këmbim të gjerë të pikëpamjeve. Qëllimi thelbësor është që të gjithë pjesëmarrësit të bien dakord për tërësinë e rregullave bazë.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të mësojnë informacione themelore për njëri-tjetrin
- Të krijohet hapësirë ku të gjithë pjesëmarrësit të ndihen të sigurt për t'i shprehur mendimet edhe kur ato janë të ndryshme nga mendimet e të tjerëve

Materialet: Letër e formatit të madh, shkruar tip marker dhe shirit ngjites për të vendosur në mur shpresat, brengat dhe nevojat që paraqiten

Koha: 15 - 30 min

Udhëzime:

1. Kërkoni nga secili pjesëmarrës që të thojë emrin, qytetin dhe vendin ku punon, si dhe rolin e tyre në shkollë. (Sa më shkurtë të jetë e mundur). Pyetni se çfarë shprehon ose çfarëçfarë presin që të mësojnë në trajnim, a kanë ndonjë brengë apo shqetësim dhe nëse kanë ndonjë nevojë të veçantë për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre.
Alternativë: Për ta kursyer kohën, mund të kërkoni nga grupi që t'i shkruajnë shpresat, shqetësimet dhe nevojat në letra individuale, në vend që të shprehen gojarisht brenda rrethit.
2. Ndërsa secili nga pjesëmarrësit flet, në fletën e formatit të madh shënoni tri lista: shpresat, shqetësimet, nevojat. (ose nëse zgjidhni alternativën, mblidhni shënimet në letra dhe grupojini sipas temave)
3. Në fund të këtij rrethi pyetni nëse do të ishin të gatshëm të hartonin disa 'rregulla bazë' për të cilat të gjithë do të binin dakord.
4. Rregullat duhet të dalin nga grupi, me ndihmën e moderatorëve nëse është e nevojshme. Siguroni që të përshihen edhe nevojat tujaa si trajner (p.sh. fikja/vënia në hesh-tje e telefonave celularë, respektimi i kohës, dëgjimi me vëmendje, mos-ndërprerja e njëri-tjetrit, nevojat për përkthim, respektimi i njëri-tjetrit).
5. Shkruani 'rregullat bazë' për të cilat është rënë dakord dhe vendosini në një vend të dukshëm gjatë tërë trajnimit.

PJESA B

Konceptet

Kjo pjesë paraqet konceptet kryesore që përdoren në këtë trajnim dhe që ndihmojnë për trajtimin e diskriminimit. Moduli i parë i kësaj pjese paraqet konceptet e diskriminimit, paragjykimeve dhe stereotipizimit në mënyrë që të jetë e pranueshme për fëmijët. Në fund të këtij aktiviteti, fjalët kyçe u shpjegohen të rriturve për të qartësuar kuptimin e tyre. Dy modulet vijues trajtojnë identitetin dhe diversitetin, si dhe tiparet unike dhe gjërat që njerëzit i kanë të përbashkëta. Ndonëse ka diçka të përbashkët ndërmjet këtyre koncepteve, ato dallojnë nga njëri-tjetri. Mesazhi kyç që duhet të transmetohet është që, pavarësisht nga etnia, prejardhja kulturore, feja, etj., të gjithë i takojnë racës njerëzore. Edhe pse të gjithë jemi unikë dhe kemi identitete të veçanta personale dhe grupe, ne kemi më shumë gjëra të përbashkëta se sa gjëra që na ndajnë. Moduli i fundit ka të bëjë me krijimin e një mjedisi të respektit për të gjithë sepse ne jemi në këtë planet së bashku me të gjithë njerëzit e tjerë. Çfarë do të thotë të respektojmë veten dhe të tjerët, dhe si duket kjo në praktikë? Shpresa është që ky modul të ndihmojë për krijimin e një kulture të respektit në të gjitha klasat, ku asnjë formë e diskriminimit nuk do të ishte e pranueshme.

6. Kuptimi se çfarë është diskriminimi

Mos gjyko se çfarë ka në kuti nisur nga mbështjellësja e saj

Arsyetimi: Në këtë modul zbatohen aktivitete për t'í ndihmuar fëmijët të kuptojnë se çfarë do të thotë diskriminimi dhe paragjykimi (pa iu referuar këtyre fjalëve të gjata). Qëllimi është që të jetë zbatimës dhe i kuptueshëm, ndërsa përçon mesazhin e rëndësishëm derisatë arrij qëllimin. Pjesa e fundit e aktivitetit është vetëm për mësuesit. Dëgjohen dhe shpjegohen fjalët kyçe dhe pastaj përdoren rastet studimore për t'í ndihmuar mësuesit të kuptojnë se si zbatohen në praktikë këto fjalë.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të paraqesë konceptet e stereotipizimit dhe paragjykimeve në atë nivel të cilin fëmijët e kuptojnë
- Të krijohet mundësia që fëmijët të mendojnë për çfarëdo paragjykimi që mund të kenë dhe se si kjo mund të ndikojë në sjelljen e tyre
- Të zhvillohen aftësitë e dëgjimit të përrallave popullore
- Të mësojnë për të kuptuar mesazhet që përmbajnë përrallat popullore.

Koha: 50 – 60 min

Mjetet mësimore: Një ose më shumë përralla të njohura, disa kuti siç saktësohet te udhëzimet, kopje të udhëzuesit, (vetëm për të rriturit)

1. Paraqitni para grupit disa kuti.
Për shembull:
 - Një kuti që përmban një tren lodër e mbështjellë me letër me një ngjyrë që zakonisht u jepet vajzave (me ngjyrë rozë ose me fotografi të kukullave)
 - Një kuti që përmban një kukull e mbështjellë me letër me ngjyrë dhe me fotografi të trenave lodër nga jashtë
 - Një kuti me shkëlqim me mbeturina brenda
 - Disa lapsa për ngjyrosje ose lodra të vogla për fëmijë, brenda një kutie të thjeshtë prej kartoni

2. Pyeteni grupin se çfarë mendojnë se mund të ketë në këto kuti?
Çfarë mendojnë se ka brenda kutive në bazë të asaj që shohin? Pyetini: nëse do të merrnin një të një nga kutitë – cilën do të zgjidhnin dhe pse? (5 – 10 min)
3. Hapini kutitë para grupit.
Pyeteni grupin se a janë të befashuar me ato që u gjetën në kuti?
Pyetini nëse ka ndryshuar diçka, kur kuptuan se çfarë kishte në kuti?
4. Paraqitni para grupit edhe disa kuti të tjera. Mund të përdorni të njëjtat mbështjellëse, por me objekte të ndryshme brenda:
- Kutitë me mbeturina ose baltë, e mbështjellë me gazetë
 - Veturë lodër e mbështjellë me letër shkëlqyese
 - Çokolata mbështjellë brenda një kutie të thjeshtë prej kartoni
- Sërish, pyeteni grupin se çfarë mendojnë se ka në kuti dhe pastaj hapini kutitë së bashku me grupin.
Pyeteni grupin nëse janë befashuar me ato që u gjetën në kuti?
Pyetini nëse ka ndryshuar diçka kur kuptuan se çfarë kishte në kuti?
5. Tani, lexoni para grupit një ose më shumë përralla që janë të mirënjohura në kulturën tuaj.
Disa shembuj: (5 – 10 min)
Hirushja: Hirushja ka dy motra, por trajtohet si skllave nga ato. Të dyja motrat e saj dëshirojnë të martohen me princin, por Hirushja nuk lejohet as të shkojë në ballo. Mrekullia ndodhi dhe ajo shkon në ballo, princi dashurohet në të, dhe të nesërmen ai shkon për ta gjetur. Hirushja martohet me princin dhe të dy jetojnë të lumtur, përgjithmonë.
(Motrat e Hirushes nuk kanë mendim të mirë për të, edhe pse ajo punon me zell dhe është vajzë e mirë. Hirushja është vajza e zgjedhur nga princi, duke e dëshmuar mirësinë e saj.)
Bretku: Një princeshë takohet me një bretk dhe i duket i neveritshëm, por në fund ajo miqësohet me të, ai e bind vajzën që ta puthë ose të flejë për tri netë në shtratin e saj. Më pas, bretku shndërrohet në princ të bukur dhe martohet dhe të dy jetojnë të lumtur, përgjithmonë.
(Në fillim princeshës nuk i pëlqen bretku, por përshtypjet e saj të para nuk ishin të vërteta, sepse ai shndërrohet në një princ të pashëm)

Breshka dhe lepuri: Breshka dhe lepuri vendosën të bëjnë një garë. Në fillim, lepuri vrapoi shumë shpejt, po më pas vendosi të bëjë një pushim e të shplodhet pak. Në fund, breshka fiton garën.

(Duket sikur lepuri do ta fitojë garën, po është në fakt breshka e ngadaltë po këmbëngulëse që arrin e para në finish)

Djali që thërriste ‘ujku-ujku’

Ishte njëherë një djalë që u punonte gjithmonë rrengje banorëve të fshatit, duke thirrur ‘ujku-ujku’, kur nuk kishte një të tillë. Një ditë, ujku u shfaq vërtetë, por askush nuk e besoi djalin dhe ujku i mbyti të gjitha delet e fshatit.

(Fshatarët menduan se djali po gënjente si gjithmonë, po këtë herë po tregonte të vërtetën. Megjithatë, askush nuk e besoi.)

Pyetini nxënësit se cili është mesazhi i tregimit?

Ju duhet t’i ndihmoni që të kuptojnë:

- Se gjërat nuk janë gjithmonë ashtu si duken.
- Kur pret diçka nga një person tjetër, nganjëherë pritjet e tua nuk janë të sakta. Nganjëherë, përshtypjet e para për njerëzit e tjerë nuk janë të sakta. Ndhimojini fëmijët të imagjinojnë se çfarë do të ndodhte nëse personazhi në tregim nuk do ta ndryshonte përshtypjen për të tjerët. A do të kishte sërish fund të lumtur? (10 – 15 min)

6. Pyeteni grupin në kanë qenë ndonjëherë në situatë kur kanë pasur pritshmëri për dikë dhe ka dalë se ato nuk kanë qenë të sakta. Është me rëndësi të theksoni se nuk ka asgjë të keqe kur ndodh një gjë e tillë. (Kështu ndodh shpesh)! Pyetni se çfarë ka ndodhur, pasi kanë kuptuar se përshtypjet e para kanë qenë të gabuara. (5 – 10 min)
7. Mund ta përmbyllni aktivitetin duke sjellë edhe disa kuti me sende të ndryshme brenda, të mbështjella me mbështjellës të ndryshëm. Me shpresë se tani kur t’i pyetni fëmijët se çfarë ka në kuti, ata do t’ju thonë se nuk e dinë meqë shohin vetëm mbështjellësit. (5 min)
8. Për ta përmbyllur aktivitetin me mësuesit Jepuni udhëzuesin, i cili i përkufizon këto fjalë. Jepuni disa minuta që grupi t’i lexojë këto përkufizime. Pyetini nëse kanë pyetje ose u nevojiten qartësime.

Udhëzues:	Përkufizimet dhe shprehjet
Stereotipi	Përgjithësim shumë i thjeshtëzuar për të karakterizuar ose kategorizuar një person ose grup të njerëzve, që nuk merr parasysh dallimet individuale.
Paragjykimi	Gjykim ose mendim i formuar paraprakisht për një person ose ngjarje pa pasur informacione të sakta ose të mjaftueshme.
Diskriminimi	Dallimi në favor ose kundër, ose trajtimi ndryshe në bazë të grupit ose kategorisë të cilës i takon personi (ose grup personash) (– dhe jo në bazë të meritave të atij personi (ose grupi personash).
Diversiteti	Dallimi, jo ngjashmëria, ndryshimi.
Racizmi	<p>Ubejdenje ili doktrina prema kojoj razlike između raznih ljudskih rasa određuju kulturna ili pojedinačna dostignuća, a obično podrazumijeva i ideju da je vlastita rasa superiorna.</p> <p>Racizmi ndërton një besim ose doktrinë në dallimet e thelbësore midis njerëzve me karakteristika të paracaktuara të kategorizuara sipas racës. Sipas këtij besimi përkaësia në një racë të caktuar njerëzore përcakton arritjet kulturore ose individuale, zakonisht përfshin idenë se raca e vetë personit është superiore.</p>
Jo toleranca	Mosdëshira ose refuzimi për të toleruar ose respektuar mendime ose besime të kundërta, ose persona kur janë të ndryshëm, veçanërisht kur bazohen në kulturë të ndryshme, prejardhje, racë, etj.
Urrejtja	Mospëlqim intensiv, antipati e skajshme, armiqësi
Krimet e urrejtjes	Veprime të paligjshme të motivuara nga paragjykimi ose urrejtja në bazë të racës, etnisë, fesë, gjinisë, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar.

7. Identiteti dhe diversiteti

a) *Identitetet e ndryshme*

Arsyetimi: Ky aktivitet i ndihmon pjesëmarrësit të kuptojnë se të gjithë kemi identitet unik i cili përbëhet nga pjesë të ndryshme dhe trashëgimi të ndryshme, dhe se ka diversitet në çdo grup njerëzish meqë ne të gjithë kemi prejardhje disi të ndryshme.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të kuptojnë se ne të gjithë kemi pjesë të ndryshme në identitetin tonë unik
- Të kuptojnë më shumë për identitetin e vet dhe atë të njerëzve të tjerë në grup
- Të identifikojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes personave në grup
- Të kuptojnë se identiteti ndërtohet dhe se gjithëkush duhet të jetë i lirë të ndërtojë identitetin e vet.

Mjetet e nevojshme: Letër e madhe për secilin pjesëmarrës, ngjitës, revista të ndryshme me fotografi dhe tekste, fotografi, kartolina, gërshtë, lapsa me ngjyra, shkumës me ngjyra, lapsa.

Koha: 45 min

Udhëzime:

1. Paraqiteni këtë aktivitet duke biseduar për identitetin dhe shpjegoni se të gjithë kemi aspekte të ndryshme në identitetin tonë: 'unë jam grua, nënë, vajzë, motër, hallë, kushëri, jam katolik, jam irlandez, jetoj në Budapest, jam muzikant, artist, kopshtar, tifoz i Klubit të Futbollit Liverpool' (dhe shembuj të tjerë relevantë) (5 min)
2. Shpjegoni se duhet të krijojnë një paraqitje të ilustruar të identitetit të tyre. Mund të përdorin vizatime, fotografi, të vizatoni veten ose të shkruajnë fjalë. Mund të përfshijnë një fotografi të vetën. Çdokush ka mënyrën e vet të paraqitjes. Një person që është tifoz i futbollit mund të vendosë shumë fotografi të lojtarëve të futbollit, dhe nëse ai nget biçikletën mund të shtojë edhe një fotografi të tillë. Një person tjetër thjesht mund t'i presë fotografitë që vërtet i pëlqen dhe t'i kombinojë në mënyrë unike dhe të thotë – kjo është mënyra se si e paraqes identitetin tim përmes të gjitha këtyre gjërave që më pëlqejnë. (20 min)

Shënim: Ka mundësi që grup-mosha të ndryshme të fëmijëve ta interpretojnë këtë aktivitet në nivelin e tyre të moshës. Gjatë punës me fëmijë, ndihmojini që të gjejnë mënyrën e tyre unike për ta shprehur veten në këtë aktivitet.

3. Kërkoni nga grupi që të shikojnë punimet e njëri-tjetrit. Pastaj shtroni pyetjet e mëposhtme:
 - A janë këto krijime saktësisht të njëjta?
 - A ka ngjashmëri mes disa prej tyre, dhe cilat janë ato?
 - A është ndonjëri punim ‘më i mirë’ se të tjerët? (Si mund të përkufizohet ‘më i mirë’? Mund të ketë disa të tillë që subjektivisht janë më të këndshme për syrin ose që i parapëlqejnë – por shpjegoni se nuk është e mundur të thuhet – ‘kjo është e mirë’ ose ‘kjo është e keqe’. Secili person vetëm ka përdorur disa pamje për të shprehur diçka për veten e tij.) (5 min)

4. Diskutim (10 min)
Përdorni pyetjet në vijim për të nxitur diskutimin:
 - A keni mësuar diçka në këtë aktivitet për vete dhe të tjerët?
 - A jeni befasuar me ndonjë gjë?
 - Çfarë ju mëson ky aktivitet për diversitetin?

Në rastin e fëmijëve më të rritur dhe personave madhorë mund t’u bëni pyetjen të shohin aspekte të ndryshme të identitetit sipas përkufizimit të tyre dhe pyetini:

- Vetëm kaq jeni?
- A jeni person i njëjtë me dikë tjetër që e ka përkufizuar identitetin e vet në të njëjtën mënyrë si ti?
- Ndhimjojini të kuptojnë se ‘kush je’ nuk është ‘identiteti yt’. Identiteti ndërtohet– dhe gjithëkush duhet të jetë i lirë të ndërtojë identitetin e vet. ‘Kush je’ është shumë më tepër se identiteti yt.

b) *Shkëmbim idesh për diversitetin*

Arsyetimi: Ky është një aktivitet i shkurtër për ta ndihmuar grupin që të kuptojë se çfarë nënkupton diversiteti dhe se si çdo grup e paraqet diversitetin e identitetit meqë identiteti i tij është shumë-shtresor.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të identifikojnë pjesë të ndryshme që përbëjnë identitetin
- Të kuptojnë që gjithmonë në çdo grup do të ketë diversitet të identiteteve

Mjetet: Fletë formati të mëdha, fletë të vogla, hapësirë për lëvizje

Koha: (20 min)

Udhëzime:

1. Shpjegoni kuptimin e fjalës 'identitet'. (Fjalori e përkufizon 'identitetin' si tërësi e sjelljeve ose karakteristikave personale me anë të të cilave një person njihet si pjesë e një grupi. Identiteti ka të bëjë me personalitetin e dallueshëm të një individi që konsiderohet si subjekt i dallueshëm. Mund të thoni se identiteti është mënyra se si i përgjigjesh zakonisht pyetjes 'Kush jam unë?'. Tregoni se secili nga ne kemi pjesë të ndryshme të këtij identiteti (dhe se të gjithë jemi shumë më tepër se sa 'identiteti'ynë). Mund t'i pyetni se a janë plotësisht të njëjtë në shkollë, në shtëpi, në jetën private, etj. Sigurohuni që të kuptojnë se secili individ ka identitet unik me kombinim të ndryshëm të pjesëve që përbëjnë identitetin e tyre, për shembull, në bazë të fesë, prejardhjes etnike, dhe interesave. (5 min)
2. Ndajeni grupin në grupe të vogla dhe kërkoni që të këmbëjnë ide për të gjitha ato mënyra të cilat kontribuojnë në identitetin e një personi. (5 min)
3. Komentoni para grupit të madh. Kërkoni nga secili grup që t'i paraqesin të gjitha idetë e tyre – sigurohuni që të kërkoni vetëm ide të reja – shtoni ndonjë ide që mungon – (sigurohuni që të përfshini: gjininë, vendin e prejardhjes, vendin ku jeton, kulturën, kombësinë, fenë, profesionin, interesat, aftësinë e kufizuar fizike dhe mendore, orientimin seksual). (5 min)
4. Shpjegoni se çdo person ka aspekte të shumëfishta të identitetit të tij dhe, për shkak të kësaj, gjithmonë do të ketë diversitet të identiteteve në çdo grup të njerëzve.

Alternativa: Ilustrojeni këtë përmes një loje të shpejtë. Zgjidhni ndonjë aspekt të identitetit të paraqitur nga grupi. Ndajini pjesëmarrësit në grupe sipas identitetit të tyre. Bëjeni këtë me ritëm të shpejtë. Do ta kuptoni se për çdo aspekt të identitetit që përmendni, do të ketë grupime të ndryshme të pjesëmarrësve. Zgjidhni aspektet e identitetit me kujdes në mënyrë që grupi të ndihet rehat me zbulimin e këtyre aspekteve për veten e tyre para pjesëmarrësve të tjerë. Kini kujdes të mos bëni pyetje që u kërkojnë njerëzve të tregojnë gjëra në lidhje me veten, të cilat do të parapëlqenin t'i mbanin private (dhe mos zgjidhni aspekte që mund të krijojnë grupe me një ose dy persona) (5 min)

8. Veçantia dhe humaniteti

a) *Duart sekrete*

Arsyetimi: Qëllimi i këtij aktiviteti është t'i ndihmojë njerëzit të kuptojnë se kemi shumë më shumë përvoja të përbashkëta se sa shpesh mendojmë, dhe thekson dallimet në përvojat tona. Pyetjet që paraqiten mund të përshtaten me moshën e pjesëmarrësve. Po ashtu, aktiviteti do të nxjerrë në pah dallimet e fshehura të cilat nuk janë vërtetuar ende, dhe mund të ndihmojnë për thyerjen e barrierave që mund të nxisin veprime të pakëndshme. Duke vërtetuar se njerëzit e tjerë ndajnë shpresa dhe shqetësime të ngjashme me tonat, kjo mund ta ndihmojë grupin ta ndërtojë besimin në vete dhe në njëri-tjetrin. Gjithashtu, ky aktivitet i nxit pjesëmarrësit të jenë të sinqertë dhe t'i besojnë njëri-tjetrit në një mjedis të sigurt dhe përkrahës.

Rezultatet e mësimnxënies:

- T'u japë pjesëmarrësve mundësinë për të zbuluar aspekte të përvojës së tyre të cilat të tjerët mund të mos i dinë
- Të mësojnë se shumë njerëz kanë përvoja të ngjashme me tonat – edhe nëse njerëzit janë të ndryshëm nga ne

Mjetet: Karrike të vendosura në formë rrethi

Koha: 45 minuta - 1 orë

Udhëzime:

1. Shpjegoni para grupit se ky aktivitet do të paraqesë ngjashmëritë dhe dallimet në grup. Shpjegoni se pas pak do t'u kërkonte të gjithëve të mbyllin sytë. Duhet të kërkonte nga grupi që të premtojë 'me fjalë nderi' se nuk do të

mashtrojnë dhe nuk do të shikojnë (ose përdor lidhëse për sytë). Shpjegojuni se do t' u lexoni disa deklarata dhe nëse kanë pasur përvojë të tillë, të ngrenë dorën. Të gjithë duhet t' i kenë sytë të mbyllur; asnjëri nuk do ta dijë se kush e ka ngritur dorën e kush jo.

Nëse mendoni se jo të gjithë pjesëmarrësit mund t' i mbajnë sytë të mbyllur, kërkojuni të shtrihen në dysheme. Së bashku duhet të formojnë një yll, ku kokat janë në mes dhe këmbët dretjuar nga jashtë. Më pas, u thoni të mbyllin sytë. Në këtë rast, edhe nëse 'mashtrojnë' dhe i hapin sytë, nuk do të jenë në gjendje të shohin se e kujt është dora, edhe po të arrijnë të shohin diçka

Shpjegoni se më pas, do të diskutohet brenda grupit se çfarë ka ndodhur. Verifikoni nëse ka ndonjë pyetje. (5 min)

2. Tani i thoni grupit t' i mbyllin sytë (pasi ta merrni fjalën e tyre të nderit se askush nuk do të mashtrojë) dhe që ushtrimi duhet të bëhet në qetësi.

Lexoni pohimet, një e nga një:

Për shembull: Ngrini dorën nëse jeni fëmija më i vogël në familjen tuaj.

Pasi t' i kenë ngritur duart, thoni: 'Mund të dëshironi që të dini se (p.sh. më shumë se gjysma e klasës i kanë ngritur duart'. Faleminderit, tani ulni duart.

Veprimi tjetër

(Shembujt e pohimeve mund t' i gjeni në faqen 37). Rekomandohen lloje të ndryshme pohimesh, sipas përbërjes së grupit, të rritur apo fëmijë. Pohimet e përdorura duhet të zgjidhen me kujdes dhe duhet të jenë të përshatshme për moshën e pjesëmarrësve dhe të situatës në të cilën punoni))

Pyetjet dhe koha duhet të përshtaten në varësi të grup-moshës së pjesëmarrësve. (20 min)

3. Në fund të ushtrimit bashkoheni grupin dhe mirëprisni komentet e tyre. (20 min)
 - Si u ndjetë kur kuptuat se shumë prej jush i kishin ngritur duart?
 - Cila ishte pjesa më e vështirë për ju?
 - A ju befaso diçka?
 - Këto që mësuat në këtë aktivitet, a ju kanë ndihmuar të kuptuarit se mund të keni gjëra të përbashkëta me njerëz të tjerë të grupit? Si ju bën të ndiheni?

Nëse e trajtoni çështjen e ngacmimit dhe bezdisjes në pohimet që i paraqitni grupit, mund të jetë e përshtatshme që t'ua shtroni edhe këto pyetje si pjesë e një diskutimi të përgjithshëm në grup.

Kini parasysh që pjesëmarrësit mund të ndajnë përvoja që janë të dhimbshme apo sfiduese, ndaj tema duhet të trajtohet me ndjeshmëri.

- Si ndiheni kur ngacmoheni për diçka që nuk mund ta ndryshoni?
- Pse mendoni se njerëzit e tjerë ngacmojnë?
- Flisni për rrethin e ngacmimit, kur ju thërrasin me emra ofendues, etj.
- Si mund ta ndalni këtë rreth?
- Pse është e rëndësishme që të jeni aleatë me njëri-tjetrin?
- A ka ndonjë mendim përmbyllës?

Ngrini dorën nëse: – Përzgjidhni nga lista

Të rriturit

Keni vizituar një shtet tjetër
Jeni më i moshuari në familjen tuaj
Ju ka vdekur së paku njëri prind
Vini nga një familje me katër apo më shumë fëmijë
Ju pëlqen vendi ku jetoni
Jeni fëmijë i vetëm
Nganjëherë keni pak vetëvlerësim
Nganjëherë ndiheni të vetmuar
Nganjëherë ndiheni të larguar apo të shkëputur
Dini pak për trashëgiminë kulturore
Do të dëshironit të kishit më shumë para
Keni qarë muajin e kaluar
Keni qarë së paku një herë gjatë këtij viti për dikë tjetër apo diçka tjetër
E konsideroni vetën si atlet
Keni qenë ndonjëherë të diskriminuar për shkak të asaj që jeni apo besoni
E dini se çfarë pasioni keni

Fëmijët

Jeni fëmija më i madh në familje
Jeni vënë në siklet ndonjëherë
Keni qarë gjatë kësaj jave
Keni bërë diçka për të cilën krenoheni
Keni dëshirë të luani futboll
Keni bërë ndonjëherë diçka për të cilën turpëroheni
Ju kanë ngacmuar, thirrur me emra ofendues apo keni qenë objekt i talljeve
Jeni të mirë në art
Jeni zgjedhur ndonjëherë i fundit në lojëra apo sporte apo jeni lënë tërësisht jashtë ndonjë aktiviteti
Jeni thirrur ndonjëherë me ndonjë emër ofendues apo poshtëruar për shkak se jeni vajzë
Keni pasur ndonjëherë mik të fshehtë
Jeni gjykuar apo ngacmuar ndonjëherë për shkak të ngjyrës së lëkurës.
Jeni këngëtar i mirë
Ndiheni ndryshe nga fëmijët e tjerë në këtë klasë
Jeni ngacmuar ndonjëherë për shkak të përkatësisë tuaj fetare
Keni ndihmuar dikë këtë javë
Flisni më tepër se një gjuhë
Keni shumë miq
Jeni ngacmuar ndonjëherë për theksin apo zërin tuaj, apo ju kanë thënë që nuk dini të këndoni
Ju apo dikush në familjen tuaj apo shok i juaji ka ndonjë aftësi të kufizuar që nuk mund të shihet
Jeni djalë dhe ju kanë thënë ndonjëherë që nuk duhet të qani, të shfaqni emocionet apo të keni frikë
Jeni ndjerë ndonjëherë i/e vetmuar, i/e padëshiruar apo i/e frikësuar
Qëllimisht ia keni lënduar ndjenjat dikujt
Ju pëlqen vendi ku jetoni
Jeni ngritur dhe keni parë ndonjëherë ndërsa dikush është lënduar dhe nuk keni thënë apo bërë diçka për shkak se keni qenë shumë i frikësuar
Njerëzit jua shqiptojnë emrin gabim, në mënyrë rutinë
Jeni ngacmuar ndonjëherë për shkak të vendit apo shtetit prej të cilit vjen familja juaj
Keni shumë vëllezër dhe motra
Keni qenë ndonjëherë personi i vetëm me racën/etninë tuaj në klasë

b) *Marrje e ideve lidhur me aspektet e përbashkëta njerëzore*

Arsyetimi: Në këtë aktivitet, grupi do të hartojë një listë të gjërave që të gjitha qeniet njerëzore i kanë të përbashkëta, ndonëse të gjithë jemi të veçantë. Qëllimi i këtij ushtrimi është që të ndihmohen pjesëmarrësit të identifikohen me të gjithë njerëzit, jo vetëm me personat që janë “si ata” me qëllim që të ndërtojnë ndjeshmëri dhe dhembshuri. Ata duhet ta kuptojnë që do të kenë disa aspekte të përbashkëta me të tjerët dhe disa aspekte ku ndjehen më ndryshe. (Kjo do të jetë e vërtetë për secilin grup – por që aspektet e përbashkëta dhe të ndryshme do të jenë të ndryshme në secilin grup ku gjenden).

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të identifikohen disa nga elementet kryesore të përvojave të përbashkëta njerëzore
- Të mësohen që të krijojnë ndjeshmëri dhe dhembshuri për qeniet e tjera njerëzore nga ky identifikim i përvojave të përbashkëta njerëzore – a janë njerëzit ‘të ngjashëm’ apo të ‘ndryshëm’ me ne.

Mjetet: Letër e madhe, lapsa marker

Koha: 30 min

Udhëzime:

1. Kërkoni nga grupi që të reflektojë për gjërat që të gjithë njerëzit i kanë të përbashkëta – ose si marrje e ideve nga i tërë grupi, ose në grupe të vogla përmes letrave të vogla ngjitëse. Sigurohuni që të përfshijnë edhe njerëz të tjerë në këtë reflektim.
(Disa shembuj për përfshirje: zemra, mushkëritë që marrin frymë, të gjithë e njohin dhimbjen, të gjithë kanë aftësi për t’u kënaqur, për të qeshur, dashuruar, urreyer, për të bërë gjëra të mira, gjëra të këqija, të gjithë do të vdesin një ditë, të gjithë vuajnë nga humbja, të gjithë kanë sfida të vështira, të gjithë duan që të dashurohen, pëlqehen, mbijetojnë, kanë dëshira dhe ëndrra)
Nëse e bëni këtë aktivitet në grupe të vogla, kur të mblidhni ide, le të kontribuojë secili grup me nga një përgjigje dhe thoni që të shtojnë vetëm ide të reja derisa t’i keni marrë të gjitha idetë nga të gjitha grupet. (15 min)
2. Jepuni disa momente për vetereflektim dhe kërkoni nga pjesëmarrësit që të mendojnë për dikë që është shumë i ndryshëm nga ta, të cilin e njohin, dhe kërkoni që të

mendojnë për të gjitha ato cilësi që i kanë të përbashkëta me këta njerëz të ndryshëm nga ta. (5 min).

Le të reflektojnë pjesëmarrësit për një gamë të gjerë të gjërave dhe personave me të cilët kanë diçka të përbashkët – për shembull një fëmijë në Afrikë mund të jetë xheloz në vël-lain e tij të madh në të njëjtën mënyrë si një fëmijë në Irlandë. Ata në Bosnje mund të kenë një mësues të tmerrshëm të his-torisë sikur se një fëmijë në Francë apo Amerikë. Reflektoni në lidhjen që mund të bëhet me të tjerët të cilët mund të kenë probleme të ngjashme si ju në jetën e përditshme, ndonëse rrethanat e jashtme mund të jenë shumë të ndryshme.

Alternativa: Përsëriteni këtë vetëreflektim me personin të cilin ata nuk e njohin dhe i cili është ndryshe nga ta. Kjo i sfidon pjesëmarrësit deri në nivelin tjetër. Mund të jetë sfiduese kur kuptojmë që kemi gjëra të përbashkëta me njerëzit që nuk i njohim dhe për të cilët ndjehemi ndryshe. Ne të gjithë jemi qenie njerë-zore, dhe mbledhja e ideve ka ndihmuar për të identifikuar gjërat që kemi të për-bashkëta me të gjithë.

3. Udhëhiqni një diskutim të shkurtër për këtë ushtrim. (10 min)
Çfarë keni mësuar?
A ju ka befasuar ndonjë gjë?
A ka ndryshuar ndonjë gjë tani kur mendoni për njerëzit që janë ndryshe nga ju nga kjo perspektivë e aspekteve të për-bashkëta të qenieve njerëzore?

9. Krijimi i një mjedisi respekti për të gjithë

a) *Vlerësimi i vetes dhe e njeri-tjetrit*

Arsyetimi: Ky aktivitet do t'i ndihmojë pjesëmarrësit ta vlerësojnë vetën për atë që janë, dhe ta çmojnë faktin që kanë gjëra me vlerë për t'i dhënë botës. Duke e ndarë punën e tyre me njeri-tjetrin, ata duhet të mësojnë edhe faktin që çdon-jëri ka gjëra me të cilat mund të kontribuojë, dhe që çdonjëri është pjesë e nevo-jshme që kontribuon me gjërat që ka e të cilat askush tjetër nuk i ka.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të mësojnë që t'i çmojnë cilësitë e mira të njeriut
- Të mësojnë që secili individ ka cilësi të mira dhe që mund t'i respektojmë dhe çmojmë cilësitë tona të mira dhe cilësitë e mira të njeri-tjetrit.

Mjetet: Letër, stilolapsa me ngjyra, shkurtesa me ngjyra

Koha: 30 - 40 min

Udhëzime:

1. Kërkoni nga personat në grup që t'i mbyllin sytë dhe të mendojnë për diçka që ata e kanë bërë sot për të cilën ndjehen mirë, dhe diçka për të cilën janë krenarë (që e kanë bërë një ditë më parë). Kërkojuni që ta tregojnë me sa më shumë detaje. Çfarë kanë bërë? Cila ishte gjëja që i bëri të ndjehen mirë lidhur me të? Thuajuni të sjellin sa më shumë detaje për situatën, ndjenjat që kanë pasur në atë kohë, dhe ndjenjat sensacionale që i kishin në trupin e tyre. Ndoshta mund të ketë qenë shënimi i një goli, gjatë pushimit, këndimi i një kënge, apo ecja në shtëpi apo...
Pyetini se çfarë kanë bërë; me çfarë kanë kontribuar në atë situatë që i ka bërë të ndjehen mirë dhe që u ka pëlqyer. Pyetini nëse ka pasur persona të tjerë aty, kush ishin ata dhe si u ndjen për këta persona të tjerë. (5 min)
2. Tani kërkoni të vizatojnë një pikturë të vetës së tyre në atë situatë, dhe vizatimi duhet t'i ndihmojë që të qëndrojnë në kontakt me këtë moment të mirë. Ata mund të shtojnë disa fjalë që përshkruajnë veprimet që kishin çuar në këtë moment të mirë – disa nga aftësitë e tyre, gjëra për të cilat janë të aftë e të zotë. (10 – 15 min)
3. Kërkoni nga personat në grup të shikojnë punën e njeri-tjetrit. Ata duhet të shohin se që të gjithë i kanë pasur momentet e mira në ditën e tyre dhe që të gjithë kanë pasur aftësi të cilat i kanë përdorur me kënaqësi. (5 – 10 mins)
4. Nga diskutimi nxirrni përfundimin që ata nuk kanë nevojë të garojnë me njeri-tjetrin, dhe që të gjithë kanë diçka me rëndësi për të kontribuar. Sigurohuni që të theksoni se të gjitha gjërat që kontribuojnë njerëzit janë të vlefshme dhe të veçanta. (5 – 10 min)

b) *Receta e respektit*

Arsyetimi: Veçori e respektit është se i ndihmon njerëzit të jetojnë së bashku dhe të kalojnë mirë së bashku në jetë. Kjo është e vërtetë pavarësisht se për kë bëhet fjalë. Aktiviteti i ndihmon pjesëmarrësit ta kuptojnë se çfarë është respekti dhe çfarë kushtesh duhen plotësuar për të zhvilluar respektin për vetën tonë dhe për njeri-tjetrin.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të jenë në gjendje të sqarojnë se fjala ‘respekt’ nënkupton respektin në praktikë
- Të sqarojnë dhe identifikojnë kushtet që duhet të ekzistojnë për të pasur respekt

Mjetet: Hapësirë për grupin, letër, lapsa, stilolapsa me ngjyra dhe shumësia me ngjyra

Koha: 30 - 40 min

Udhëzime:

1. Sqaroheni që ky aktivitet ka të bëjë me respektin. Pyetini se a e dine çfarë do të thotë kjo fjalë.
2. Sqaroheni në mënyrë që të gjithë ta dinë se çfarë nënkupton fjala “respekt”. (Fjalori e përkufizon respektin si ‘vullneti për të shfaqur vlerësim apo shqetësim, ‘për të shfaqur konsideratë në mënyrë të sjellshme ndaj dikujt’ dhe për ‘t’i trajtuar tjerët me mirësi’.
3. Sqarohuni që do t’i parashtroni disa pyetje të përgjithshme lidhur me respektin për gjithë grupin dhe pastaj ata do të ndahen në grupe të vogla për pjesën tjetër të aktivitetit. Kërkoni nga grupi që të japë shembuj se si mund të shfaqet respekt për:
 - Vetën tuaj? (Për shembull duke u larë rregullisht dhe duke u kujdesur si duhet për pamjen e jashtme, duke u siguruar që të flini aq sa ju nevojitet, duke i mbajtur gjërat tuaja në rregull, etj.)
 - Anëtarin e familjes tuaj
 - Mësuesin apo një figurë me autoritet
 - Një fëmijë tjetër
 - Një të rritur që nuk e njihni

Etj.

(5 – 10 min)

4. Pyetini nëse ekziston ndonjë në këtë shkollë që nuk dëshiron të trajtohet me respekt?
Pyetni nëse ekziston ndonjë person në shkollë që nuk e meriton që të trajtohet me respekt?
Nëse ka ndonjë sugjerim nga pjesëmarrësit, kërkojini që ta shpjegojnë përse mund të jetë ashtu. Shpjegojuni që edhe nëse nuk u pëlqen një person apo nëse nuk pajtohen me mendimet e tij/saj apo edhe nëse është shumë më ndryshe nga ju ai/ajo prapëseprapë meritojnë të trajtohen me respekt, edhe nëse nuk shfaqin respekt për ju. Mund të ndodhë që pjesëmarrësit të përgjigjen që kjo nuk është e drejtë. Mirëpo është me rëndësi që t'u tregoni se është në interesin e tyre më të mirë që të mbesin të respektueshëm dhe që ky nuk është faji i tyre që personi tjetër nuk di të silllet më mirë. Është me rëndësi që t'i ndihmoni pjesëmarrësit ta kuptojnë se po kërkonin nga ta që ta respektojnë personin dhe jo gjërat që i kanë bërë apo nuk i kanë bërë. (Pyetja është e kufizuar për personat në shkollë për të ndihmuar në bërjen e këtij koncepti të prekshëm për të gjithë) 5 – 10 min
5. Ndanjini pjesëmarrësit në grupe të vogla për të vendosur lidhur me recetën e respektit –
Cilët janë përbërësit kryesorë, dhe si të krijohet një mjedis respekti?
Recetën e tyre mund ta shndërrojnë në afishe. bjerë dakord Grupi mund të bjerë dakord që respekti të bëhet një nga rregullat e klasës (apo shkollës). (15 min)

Shënim: Pasi klasa të ketë rënë një një mendje për të qenë të respektueshëm ndaj njeri-tjetrit, çfarëdo incident diskriminimi apo ngacmimi që ndodhë, mund të trajtohet brenda kësaj kornize si dhe në bazë të kornizës së adresimit të diskriminimit.

PJESA C

Ndikimet

Qëllimi i kësaj pjese është që pjesëmarrësve t'u jepen disa përvoja të drejtpërdrejta të diskriminimit, me idenë që të përjetojnë dhe kuptojnë vetë se si mund të jetë kjo përvojë, që njerëzit të jenë më të ndjeshëm ndaj grupeve të pakicave. Moduli i dytë siguron mundësi për të përjetuar ndikimin e pritjeve që kanë pjesëmarrësit dhe se si kjo mund të ndikojë në performancën e tyre, në aspektin pozitiv dhe negativ.

10. Përjetimi i diskriminimit

Aktivitetet në këtë pjesë nuk janë të disponueshme për momentin, dhe do të shtohen në botime të tjera të këtij udhëzuesi.

11. Plotësimi i pritjeve

Arsyetimi: Kjo veprimtari synon që të shtyjë pjesëmarrësit të shqyrtojnë ndikimin e mesazheve që pranojnë nga njerëzit përreth tyre dhe se si kjo gjë ndikon në sjelljen dhe rezultatet përkatëse. Disa nga pjesëtarë të grupit do të marrin pjesë në veprimtari, kurse të tjerët do t'i udhëzojnë. Grupe të ndryshme të pjesëmarrësve do të marrin lloje të ndryshme udhëzimesh. Në fund të

veprimtarisë, pjesëmarrësit do të flasin për përvojat e tyre dhe do të pasqyrojnë çfarë kanë mësuar. Kjo veprimtari do t'i ndihmonte mësuesit të shohin ndikimin e mesazheve që u japin fëmijëve (dhe të mesazheve që fëmijët shkëmbejnë me njëri-tjetrin).

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të përjetojnë ndikimin e mesazheve pozitive dhe negative
- Të mësojnë se pritshmëritë mund të kenë një ndikim mbi personin që do të pasqyrojë natyrën e pritshmërive tuaja. Pritshmëritë pozitive priren të prodhojnë rezultate pozitive dhe pritshmëritë negative priren të prodhojnë rezultate negative
- Të hartojnë strategjitë për të krijuar pritshmëri inkurajuese dhe mbështetëse për të gjithë në mjedisin tuaj

Mjetet: Grumbull gazetash, shirit ngjites

Koha: 45 min - 1 orë

Udhëzime:

1. Prezantoni veprimtarinë duke i njoftuar pjesëmarrësit se grupi do të shqyrtojë ndikimin e pritshmërive pozitive dhe negative. Shpjegoni se, pas përfundimi të veprimtarisë, do të diskutohet se çfarë ka ndodhur dhe rëndësia e saj për këtë program trajnimi.
2. Shpjegoni se gjysma e grupit do të jenë pjesëmarrës dhe gjysma tjetër do të jenë mentorë. Detyra e pjesëmarrësve është që të punojnë në grupe të vogla dhe të ndërtojnë një kullë me materialet që u keni siguruar (shiritin ngjites dhe gazetat). Kulla duhet të jetë së paku 2 metra e lartë, e qëndrueshme, dhe duhet të qëndrojë e pambështetur diku. Ju do të caktoni një afat kohor për përfundimin e detyrës. Kontrolloni nëse të gjithë e kanë kuptuar detyrën. Përzgjidhni apo kërkoni nga pjesëmarrësit që të paraqiten vullnetarë për rolin e tyre të përzgjedhur. (5 min)
3. Podijelite 3. Ndanjii pjesëmarrësit në grupe nga 4 – 6 pjesëmarrës. Mund të ketë 2, 3 apo 4 grupe të pjesëmarrësve, në varësi të madhësisë së grupit . Përcaktoni mentorët në mënyrë që secili grup i pjesëmarrësve të ketë disa njerëz të cilët i udhëzojnë ata. Thirrni secilin grup të mentorëve në një anë dhe njoftoni si në vijim:

Një (apo dy) grupe të mentorëve udhëzohen që ta udhëzojnë grupin vetëm me mbështetje pozitive dhe vërejtje konstruktive dhe të dobishme.

Një (apo dy) grupe të mentorëve udhëzohen që të bëjnë vërejtje negative, dëmtuese dhe që mund të nënkuptojnë se personi është jointeligjent apo se e ka gabim nëse kanë provuar ndonjë ide dhe nuk ka funksionuar (për shembull). Ky grup i mentorëve, gjithashtu, duhet të përpiqet që ta ndajë grupin e pjesëmarrësve.

Nëse keni tri grupe, atëherë grupi i tretë i mentorëve duhet të jetë i paanshëm dhe të udhëzohet që vetëm të vëzhgojë dhe të mos bëjë komente. (5 min)

4. Filloni me veprimtarinë e ndërtimit të kullës me gazeta. Ju mund t'í tregoni grupit se ka kaluar gjysma e afatit kohor. Sigurohuni që mentorët të zbatojnë udhëzimet siç duhet. Pas 15 – 20 minutash ndalni veprimtarinë dhe mblidhni së bashku të gjithë grupin.
5. Mblidhni të gjithë grupin për diskutim. Tregojuni pjesëmarrësve që të lënë mënjane rolin që u është caktuar dhe të mos u tregojnë të tjerëve se çfarë roli kanë pasur.

Udhëhiqeni diskutimin dhe parashtroni pyetjet si në vijim:

- Si ndiheshit gjatë kryerjes së veprimeve?
- Si po ndiheni tani?

Përqendrohuni në përvojat e pjesëmarrësve (atyre të cilët kanë ndërtuar kullën) e të gjitha grupeve.

Mund të ndodhë që grupet që kanë marrë udhëzimet pozitive të kenë ndërtuar kulla më të larta dhe më të mira. Pa marrë parasysh rezultatin, përqendrohuni në përvojat e pjesëmarrësve dhe se si ndiheshin kur merrnin mesazhet.

Pyetini se si ndikuan mesazhet në punën e tyre?

Tani pyesni mentorët se si ndiheshin gjatë veprimtarisë dhe se çfarë kanë vrotuar?

Duhet të ekzistojë një moment kur mentorët duhty të sqarojnë rolin që u është dhënë.

Sa e lehtë apo e vështirë ka qenë për vëzhguesit të japin mesazheve që mund të kenë qenë të pazakonshme për ata?

Çfarë konstatimesh mund të nxirren?

Cili është qëllimi i veprimtarisë në kontekstin e këtij trajnimi?

Çfarë lloj mesazhesh marrin më shpesh fëmijët e grupeve pakicë?

Çfarë ndikimi ka kjo në ata?

Çfarë mund të bëhet për ta ndryshuar këtë gjë? (20 - 30 min)

PJESA D

Mjetet

Tani që pjesëmarrësit i kuptojnë mirë konceptet në fjalë dhe kur vetë kanë përjetuar diskriminimin, kjo pjesë vazhdon me mjetet për trajtimin e diskriminimit. Në këtë pjesë paraqiten katër module. Moduli i parë përdor tregimet si një mjet për të përçuar mesazhe të ndryshme pozitive; moduli i dytë është për mësuesit dhe për përdorimin e simulimit dhe rasteve studimore për të nxitur mësuesit në lidhje me mënyrat kreative për trajtimin e diskriminimit dhe ngacmimit në klasë, dhe moduli i tretë paraqet disa veprimtari që ndihmojnë në ngritjen e respektit për veten për të krijuar një mjedis pozitiv për të gjithë ku mund të punohet.

12. Përdorimi i tregimeve në luftën kundër diskriminimit

Arsyetimi: Tregimet janë një mjet i fuqishëm që përdoret në shumë tradita dhe kultura për të përçuar mesazhe të rëndësishme dhe të kuptueshme. Në këtë veprimtari, përdoret një përrallë ekzistuese si shembull dhe më pas pjesëmarrësit krijojnë tregimin e tyre që mund ta luajnë apo performojnë. Kjo veprimtari ofron mundësinë për zhvillim të mëtejshëm jashtë kontekstit të këtij trajnimi.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të zhvillojnë aftësitë e dëgjimit, të kuptohen mesazhet themelore në tregime
- Të mësojnë se si të përçojnë mesazhet duke përdorur tregimet

Koha: 60 – 90 min

Mjetet: Një përrallë/tregim që përqendrohet në dallimet dhe përkatësinë.
(për shembull, “Rosaku i shëmtuar”)

Rosaku i shëmtuar

Lind një rosak dhe ai është më i madh dhe më i shëmtuar se sa të tjerët. Ai haste vështirësi dhe nuk mund të përshtatej. Në fund, ai largohet dhe gjen një fole të braktisur ku nis të jetojë. Një ditë, rosaku sheh mjellmat duke fluturuar, del nga foleja, nis të fluturojë dhe e kupton se nuk është një rosak i shëmtuar por një mjellmë e bukur.

Udhëzime:

1. Lexoni tregimin e përzgjedhur (5 min)
2. Parashtrijini grupit pyetjet si në vijim:
 - Cili është mesazhi i këtij tregimi?
 - Çfarë keni mësuar nga tregimi?
 - A mund ta identifikoni çastin(et) kyç në tregim?
 - Përse është përfshirë ky tregim në këtë trajnim? (10 min)

Flisni me grupin për pjesët kyçe të një tregimi të mirë:

- Na ishte një herë
 - Një hero a heroinë
 - Një pengesë a sfidë që duhej të kapërcehej
 - Ndihma magjike apo dhuratat e marra
 - Një zgjedhje
 - Një zgjidhje e pengesës dhe përfundim i lumtur (5 min)
3. Ndajini pjesëmarrësit në grupe më të vogla dhe u shpjegoni se tani duhet të shkruajnë tregimin e tyre për të përçarur një mesazh pozitiv për të tejkaluar urrejtjen dhe diskriminimin. Nënvizoni se duke qenë se tregimet funksionojnë me pamje, ata duhet të jenë shumë kreativë dhe se duhet të shkojnë përtej së përditshmes. Ndoshta heroi (a heroina) ka tre durar apo dy koka ose është nga planeti Mars. Inkurajojini pjesëmarrësit të jenë sa më kreativ. (30 – 40 min).

4. Ftoni secilin grup që të lexojë me zë tregimin e tyre. Nëse keni kohë, lejoni një diskutim të përgjithshëm për të parë nëse tregimi e ka plotësuar synimin e përcimit të mesazhit që mund të ndihmojë në luftimin e diskriminimit. Kërkoni nga i gjithë grupi mendime për secilin tregim - se si mund të kishte me qenë më mirë? (15 min)

Shënim: Sa i përket të përdorimit në klasë, kjo veprimtari mund të zgjerohet duke kaluar më shumë kohë në kuptimin e pjesëve të një tregimi të mirë. Nxitini fëmijët që të krijojnë një shfaqje nga tregimi. Ndoshta mund të dilni me një shfaqje për tërë klasën për një ngjarje që shënon fundin e vitit.

13. Trajtimi i diskriminimit dhe ngacmimit në klasë

(Shënim: Kjo veprimtari është përgatitur së bashku me aktivisten për çështje të romëve, Manjola Vezi¹)

Ky modul synon të nxjerrë në pah vështrësi me të cilat përballen fëmijët romë në shkolla të përziera dhe të rrisë ndërgjegjësimin ndaj dukurisë së diskriminimit dhe izolimit.

Ky modul përdor veprimtari për t'i ndihmuar mësuesit të kuptojnë se si sjellja e tyre luan një rol të rëndësishëm për përmirësimin në nivelin e edukimit të fëmijëve romë dhe duke i inkurajuar motivimi i fëmijëve rritet, duke ndikuar direkt në rritjen e nivelit të regjistrimit dhe frekuentimit të shkollës nga fëmijët romë.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të kuptohet që shpesh mund të ndodhë që pa vetëdije fëmijët romë të diskriminohen, dhe të reflektohet për mënyra të efektshme për qasjen ndaj fëmijëve romë në klasa;
- Të dallohet /reflektohet mbi qasjet pozitive dhe negative të përdorura në praktikë;
- Të reflektohet për mënyra të ndryshme se si mësuesit mund të ndihmojnë fëmijët romë të kapërcejnë pengesat që hasin;
- Të ndihmojë për krijimin e një atmosfere besimi midis mësuesve, fëmijëve romë dhe prindërve;

1 Biografia e Manjola Vezi mund të gjendet në Aneks 1

Arsyetimi: Në rastet e studimit më poshtë, jepen raste nga jeta reale që ilustrojnë vështirësitë, disa herë të panjohura, të fëmijëve dhe prindërve romë, në përpjekje për të frekuentuar shkollën apo kur janë në klasë. Është e rëndësishme të kuptohen këto vështirësi dhe të bëhen përpjekje për të gjetur zgjidhje praktike për këto situata. Gjithashtu, është e rëndësishme që të mësohet se jo gjithçka është ashtu si duket si dhe për të përmirësuar aftësitë e dëgjimit dhe për të vënë në provë durimin e mësuesit apo asistentit në shkollë. Padyshim, edhe prindërit romë kanë një rol të rëndësishëm, po kjo do të diskutohet te veprimtaritë e përkruara te Shtojca II.

Kërkesat:

- Udhëzuesi me raste studimi praktike (shih më lart, pjesëmarrësit marrin një rast për grup)

Koha: 90 min

Udhëzime:

1. Informojini pjesëmarrësit për çfarë bën fjalë ky ushtrim. Informojini se qëllimi është të ndihmojë mësuesit të shohin këto raste për të kuptuar më mirë se sa komplekse janë dhe t'i ndihmojë të gjejnë zgjidhje. (5 min)
2. Shpjegojuni pjesëmarrësve procesin që do të ndjekin duke marrë një nga rastet si shembull, përdorni rastet dhe pyetjet për të analizuar situatën dhe për të nxjerrë zgjidhje të mundshme. Lejoni kohë të mjaftueshme për pyetje nga pjesëmarrësit për të siguruar që kuptohet si duhet. (15 min)
3. Ndajini pjesëmarrësit në grupe. Shpërndajuni rastet. (një rast për grup)
4. Kërkojuni pjesëmarrësve (mësuesve) të analizojnë situatën e dhënë dhe të identifikojnë jo vetëm veprime administrative por edhe vetjake dhe të personalizuara për të reaguar në situatën e dhënë. (20 min)

Përdorni pyetjet e mëposhtme për të zhvilluar analizën:

- Si është situata e përgjithshme?
 - Nga këndvështrimi i secilit personazh në situatë– shpjegoni si mendoni se e shohin ata situatën (secili anëtar i grupit do të luajë rolin e një personi/grupi të përfshirë në rastin e studimit)
 - Cilat mendoni janë nevojat e secilit person/grup?
 - Nevojat e cilit po plotësohen? A ka mënyra të tjera për t'i plotësuar këto nevoja?
 - Nevojat e cilit nuk po plotësohen? Si mendoni se mund të plotësoheshin?
 - A mendoni se po shkelen të drejta? Cilat të drejta? Dhe të kujt?
 - Sipas mendimit tuaj, çfarë (ose kush) duhet të ndryshojë në këtë situatë? Duhet të mendoni në mënyrë sa më kreative – të gjitha ndryshimet e mundshme mund të përfshihen në këtë fazë
 - Ku mendoni se ndryshimi është i mundur? (disa prej ndryshimeve ideale që do të dëshironit mund të mos jenë realiste
 - Çfarë mund të bëhet për të ndryshuar situatën, nga kush?
 - Çfarë mund të bëni (nëse kjo situatë do të ndodhte në shkollën tuaj) për të ndihmuar të siguroheni se këto ndryshime mund të zbatohen? (Hartoni një planveprimi).
5. Mblidheni grupin bashkë dhe secili prej grupeve të vogla të paraqesë zgjidhjen e tyre apo zgjidhje të mundshme. Ftojini pjesëmarrësit e tjerë të japin komentet e tyre (10 min për rast)
6. Në mbyllje, pyeteni grupin se çfarë pika të përgjithshme kanë mësuar? (5 min)

Pyetjet

Si është situata e përgjithshme?

Nga këndvështrimi i secilit personazh në situatë– shpjegoni si mendoni se e shohin ata situatën (secili anëtar i grupit do të luajë rolin e një personi/ grupi të përfshirë në rastin e studimit)

Cilat mendoni janë nevojat e secilit person/grup?

Nevojat e cilit po plotësohen? A ka mënyra të tjera për t'i plotësuar këto nevoja?

Nevojat e cilit nuk po plotësohen? Si mendoni se mund të plotësoheshin?

A mendoni se po shkelen të drejta? Cilat të drejta? Dhe të kujt?

Sipas mendimit tuaj, çfarë (ose kush) duhet të ndryshojë në këtë situatë? Duhet të mendoni në mënyrë sa më kreative – të gjitha ndryshimet e mundshme mund të përfshihen në këtë fazë

Ku mendoni se ndryshimi është i mundur? (disa prej ndryshimeve ideale që do të dëshironit mund të mos jenë realiste

Çfarë mund të bëhet për të ndryshuar situatën, nga kush?

Çfarë mund të bëni (nëse kjo situatë do të ndodhte në shkollën tuaj) për të ndihmuar të siguroheni se këto ndryshime mund të zbatohen? (Hartoni një planveprimi).

Personazhet e rasteve të studimit:

	Personi 1	Personi 2	Personi 3	Personi 4
Si e sheh personi situatën?				
Cilat janë nevojat e këtij personi?				
A po plotësohen nevojat e tyre? P/J				
Si mund të plotësoheshin nevojat e tyre?				
A po shkelen të drejtat e tyre?				
Cilat të drejta?				
Çfarë mund të bëjë ky person për të ndryshuar situatën?				

Tani, ju lutem shprehni rezultatin/et tuaja të preferuara për të ndryshuar situatën

Nëse kjo situatë do të ndodhte në shkollën tuaj, çfarë do të bënit që të ndodhte ndryshim? (Hartoni një planveprim)

Raste studimi (të dhëna nga Manjola Vezi):

Rasti I

Maria sapo ka mbushur shtatë vjeç. Janë ditët e fundit të gushtit dhe prindërit e saj kanë dëshirë ta regjistrojnë në shkollën afër vendbanimit të tyre. Bashkë me Marinë, ata shkojnë tek drejtori i shkollës për ta regjistruar. Ditën e parë, u thuhet të vijnë të nesërmen, pasi do të mbahet një takim i mësuesve. Ata shkojnë të nesërmen, ndërsa një asistent u thotë të dorëzojnë certifikatën e lindjes dhe librezën e vaksinimit të Marisë.

Prindërit e Marisë shkojnë tek njësia e qeverisjes vendore për të marrë certifikatën e lindjes, por zyrtari atje u thotë që nuk mund t'ua japë, për shkak se nuk kanë paguar taksën e shtëpisë. Ata kanë vështirësi të sigurojnë librezën e vaksinave të Marisë, sepse kanë qenë në udhëtime dhe ajo nuk i ka ndjekur të gjitha fazat e vaksinimit. Kthehen sërish tek drejtori dhe e informojnë për vështirësitë që kanë hasur.

Rasti II

Enea është shtatë vjeç. Ai është në klasën e parë, po nuk ka ndjekur asnjë vit të arsimit parashkollor, e tani po përballet me vështirësi në të kuptuarit e mësimëve. Enea shpesh vjen në shkollë pa kryer detyrat e shtëpisë. Mësuesi ka folur me prindërit, por ata i kanë thënë që janë analfabetë, ndaj nuk mund ta ndihmojnë me detyrat. Fëmijët e tjerë nuk duan të ulen në të njëjtën bankë me të, sepse ai është rom. Enea gjithmonë kthehet në shtëpi duke qarë dhe nuk dëshiron të shkojë në shkollë më.

Rasti III

Emanueli është një djalë energjik rom në klasën e tretë. Ai nuk është i mirë në detyra të shtëpisë, por i pëlqen shumë muzika. Ai ka dëshirë të këndojë dhe është shumë aktiv gjatë orës së muzikës. Ai i bie mirë violinës, të cilën ia ka mësuar gjyshi. Në kuadër të festimeve të Vitit të Ri, shkolla do të organizojë një koncert. Do të ftohen personalitete publike të mirënjohura. Mësuesi ka angazhuar 5 nxënës nga klasa që të përgatiten për ta përfaqësuar klasën. Emanueli nuk është angazhuar, pavarësisht se mësuesi i kishte thënë njëherë që është më i miri në orën e muzikës. Ai shkoi në shtëpi dhe u tregoi prindërve atë që kishte ndodhur.

Ata i thanë djalit që nuk ishte zgjedhur për shkak se është rom, si dhe pa marrë parasysh se sa i mirë është, nuk do ta trajtojnë në mënyrë të drejtë. Që atë ditë, kënga e Emanuelit nuk është dëgjuar më as gjatë pushimeve e as në orën e muzikës.

Rasti IV

Alesia, një vajzë rome, ishte ulur në rreshtin e parë afër një vaje që nuk ishte rome. Ato kalojnë mirë me njëra-tjetrën. Aurora ishte nxënëse e mirë, e kohë pas kohe ndihmonte edhe Alesian në kryerjen e detyrave të shtëpisë. Një ditë, nëna e Aurorës erdhi në klasë. Ajo foli me mësuesin duke thënë që mjetet mësimore të vajzës së saj po mungonin dhe që i kishte humbur në klasë. Mësuesi i tha Alesias që të shkonte në rreshtin e fundit, si dhe vendosi një djalë jo-rom afër Aurorës.

Rasti V

Prindërit romë që jetojnë në një lagje rome afër hekurudhës dëshirojnë ta regjistrojnë vajzën e tyre në shkollë fillore. Ata shkuan në shkollën e afërt me lagjen e tyre për ta regjistruar. Asistenti i drejtorit iu tha të sillnin certifikatën e lindjes dhe librezën e imunizimit të vajzës së tyre.

Pas dy ditësh, prindërit shkuan prapë në shkollë, me dokumentet e kërkuara, por asistenti iu tha që nuk kishte më hapësirë në klasa për fëmijë të tjerë, si dhe që ata duhet të shkonin në një shkollë tjetër që është në anën tjetër të hekurudhës. Ata i thanë asistentit që nuk mund ta regjistrojnë vajzën në shkollën tjetër, sepse frikësohen se asaj do t'i duhej të kalonte hekurudhën e vetme për çdo ditë. Ata punojnë me shitje të rrobave të dorës së dytë në fshatrat e afërt, si dhe nuk mund ta përcjellin deri në shkollë.

Rasti VI

Ronaldi është dhjetëvjeçar. Ai është i vetmi nxënës rom në klasë. Një ditë, mësuesi erdhi në klasë dhe kërkoi nga klasa që të ngrenë dorën ata që janë romë, sepse shkolla do t'u japë, librat shkollorë pa pagesë, pasi janë të varfër. Ronaldi nuk kishte zbuluar përkatësinë e tij etnike deri atëherë dhe nuk e ngriti dorën, sepse frikësohej se të tjerët do ta trajtonin ndryshe. Ai as nuk foli me prindërit për këtë, sepse frikësohej që do ta qortonin. Megjithatë, Ronaldi është i vetëdijshëm që prindërit e tij kanë probleme financiare.

Rasti VII

Shumë prej fëmijëve romë jetojnë në periferi të Tiranës, pranë lumit dhe nuk e frekuentojnë shkollën, pasi shkojnë bashkë me prindërit të punojnë (mbledhin materiale të riciklueshme). Skënderi, një baba rom në moshë të re, dëshiron që fëmijët e tij të shkollohen. Çdo ditë i shoqëron fëmijët në shkollë me një mjet të sajuar dhe më pas shkon të mbledhë kanaçe dhe skrap. Kur vjen ora e mbarimit të shkollës, ai vjen dhe i merr. Një ditë, kur shkoi si zakonisht të merrte fëmijët nga shkolla dhe ata i thanë se nuk donin të shkonin më në shkollë. Drejtoresha i kishte çuar te banjot e shkollës dhe i kishte çuar në banjo dhe u kishte thënë të lahashin para se të hynin në klasë. Nxënësit e tjerë i kishin përqeshur.

Kur foli me drejtoreshën, ajo i tha se donte t'i ndihmonte fëmijët pasi familja nuk ka kushtet e duhura për t'i sjellë fëmijët të pastër në shkollë. Ajo u shpreh se donte që ata të ndiheshin mirë. Fëmijët e tjerë nuk duan të shoqërohen me ta sepse "mbajnë erë".

14. Përmirësimi i imazhit/vetërespektit për të gjithë fëmijët²

Të pasurit vetë-respekt të shëndetshëm është i rëndësishëm për të gjithë ne. Gjithashu, është i rëndësishëm si për fëmijët që kanë një prirje për të ngacmuar dhe që mund të trajtojnë keq nxënës të tjerë, si edhe për ata që janë viktimë e një trajtimi të tillë. Në të vërtetë, mund të pretendohet se zhvillimi i vetë-respektit te fëmijët që kanë prirje për të ngacmuar është shumë i rëndësishëm. Duke qenë se kjo nuk është e shëndetshme dhe nuk është e dëshirueshme, është me rëndësi që të gjenden mënyra të shëndetshme që fëmijët të zhvillojnë vetë-respekt pozitiv, pra mënyra që krijojnë një ndjenjë të shëndetshme të vetvetes ndërsa në të njëjtën kohë, njohin se të gjithë kanë cilësi të mira – pra duke përfshirë veten tonë dhe të tjerët.

Veprimtaritë e propozuara në këtë modul synojnë të ndërtojnë këtë vetë-respekt të shëndetshëm dhe pozitiv. Vetë-respekti i lartë është i rëndësishëm për të gjithë – por problemet shfaqen kur vetë-respekti i njërit fitohet në kurriz të tjerëve e kjo është ajo çfarë ndodh me ngacmimin. Kjo mund të ndodhë kur vetë-respekti është i mbështetur në ndjenjën e të qenit “më i mirë” sesa të tjerat apo kur e vendosim veten më favorshëm sesa të tjerët ose duke ngacmuar të tjerët e që nuk është e shëndetshme. Megjithatë vetë-respekti i lartë pozitiv mund të fitohet duke e trajtuar veten mirë dhe duke u kujdesur mirë për vetveten – duke i kushtuar vetës vëmendjen dhe kujdesin që njëri mund të presë nga të tjerët.³

a) *Përdorimi i artit si mjet për luftimin e diskriminimit*

Arsyetimi: Kjo veprimtari e bazuar në art është përfshirë duke qenë se fëmijët janë shumë kreativ dhe shpeshherë përdorin artin për të shprehur vetveten. Shpesh, në shkollë, fëmijët kanë lëndën e artit por ekziston një burim informacioni në çdo vizatim që shpesh nuk shihet. Duhet të ekzistojë ndjeshmëri për të mbledhur këto informacione dhe për t'i ndarë ato në klasë. Kjo veprimtari krijon një strukturë për mësuesit që të mësojnë mënyrat e reja për të përdorur veprimtaritë e bazuara në art që do të ndihmojnë fëmijët të kenë një vet-respekt pozitiv. Veprimtaria u tregon mësuesve një mënyrë tjetër për të parashtruar pyetje me qëllim krijimine mundësive të reja që fëmijët të flasin për aspektet e jetës së tyre në një mënyrë të sigurt dhe pa u ndier të kërcënuar. Ajo, gjithashtu, inkurajon mësuesit që të distancohen nga miratimi i veprimeve të disa fëmijëve dhe nga mosmiratimi i veprimeve të disa fëmijëve tjerë dhe kështu të ndihmojnë në ndërtimin e besimit dhe vetë-respektit për të gjithë fëmijët në klasë.

2 Disa veprimtari në këtë pjesë janë frymëzuar dhe përshtatur nga veprimtaritë e paraqitura në Programin e Vetë-Dhembshurisë së Ndërgjegjshme, të hartuar nga Christopher Germer dhe Kristin Neff

3 Shih për shembull: <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1467-6494.2008.00537.x/pdf>
http://greatergood.berkeley.edu/article/item/try_selfcompassion/

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të mësojnë se si të përdorin pyetjet e hapura për të ndihmuar fëmijët që të hapen më shumë për jetën e tyre
- Të nxisin ndjeshmëri në klasë duke krijuar hapësirë për fëmijët që të bisedojnë në mënyrë të sigurt dhe të strukturuar
- Të mësojnë që të përdorin një teknikë për të ndihmuar fëmijët të zotërojnë aftësitë e komunikimit verbal dhe joverbal
- Të mësojnë që të krijojnë një hapësirë të sigurt dhe pa kërcënime për fëmijët për të biseduar për gjërat që kanë rëndësi për ta dhe të ndërtojnë vetë-respekt pozitiv.

Mjetet: Letër, stilolaps me ngjyrë, laps, shkurtes me ngjyrë.

Koha: 1 orë

Udhëzime:

1. Shpjegoni se kjo veprimtari është e ndarë në dy pjesë – pjesa e parë është një veprimtari e bazuar në art ku secili merr pjesë. Pjesa e dytë është për të ndihmuar mësuesit të mësojnë aftësi të reja. Shpjegoni se në pjesën e dytë të veprimtarisë mësuesit do të mësojnë të zgjerojnë mënyrat për të përdorur veprimtaritë e bazuara në art, në klasë.
2. Në pjesën e parë të veprimtarisë secili pjesëmarrës do të vizatojë një vizatim që ka të bëjë me temën që do ta përzgjidhni ju. Shembuj të përshtatshëm janë:
 - Darka në familjen time
 - Familja ime në shtëpi
 - Dita ime e zakonshme
 - Ëndrra ime për të ardhmen

Temat e sugjeruara janë neutrale dhe të zakonshme; tema duhet të jetë e kup-tueshme lehtësisht për të gjithë në grup. (10 – 15 min)

3. Mblidhni së bashku pjesëmarrësit dhe u mundësoni një moment për një shikim të shpejtë të të gjitha vizatimeve.
4. Shpjegoni se kjo pjesë e veprimtarisë është vetëm për mësuesit. Shpjegoni se do të kërkoni një (apo më shumë) vullnetarë të cilët ju do t'i "intervistoni" në mënyrë të veçantë. Mësuesit e tjerë duhet të vëzhgojnë atë se çfarë dhe se si po e kryeni intervistën për ta mësuar këtë proces e që më pas të jenë në gjendje ta zbatojnë me fëmijët/nxënësit e tyre në klasë.

5. Shpjegoni se në mënyrë që të shfrytëzohet në maksimum potenciali i këtij ushtrimi, pjesëmarrës të ndryshëm (të gjithë mësuesit) do të shqyrtojnë aspektet e ndryshme. Prandaj ndajini në së paku 7 grupe të vogla. Jepini secili grup të vogël një aspekt të ndryshëm që duhet shqyrtuar si në vijim:
- i) Cilët janë hapat në procesin e kryerjes së intervistës?
 - ii) Çfarë lloj pyetjesh po përdorni?
 - iii) Çfarë lloj komentesh po bëni?
 - iv) Si po përgjigjet personi?
 - v) Si është ky proces i ndërlidhur me trajnimin kundër diskriminimit?
 - vi) Cilat aftësi po i zhvillon personi i cili po intervistohet?
 - vii) Cilat aftësi po i zhvillojnë personat të cilët po e vëzhgojnë intervistën?
6. Kërko një vullnetar i cili është i gatshëm të prezantojë vizatimin dhe të flasë për vizatimin e tij/saj.
- a) Ulu apo qëndro në krah personit (në vend që të uleni përballë tyre, në mënyrë që të shihni të njëjtat gjëra që po i shohin ata)
 - b) Kontrolllo drejtimin e vizatimit. (Ju mund të mendoni se e dini se cili është drejtimi i drejtë – por mund ta keni gabim – sigurohuni dhe kontrolllojeni këtë gjë)
 - c) Kërko nga vullnetari që të flasë për vizatimin
 - d) Pyete se cila është pjesa më e rëndësishme e vizatimit dhe se çfarë domethënie ka për atë.
 - e) Pyete se si është ndjerë kur ka vizatuar vizatimin dhe se si po ndihet tani.
 - f) Parashtro çfarëdo pyetje tjetër të hapur që i jep mundësinë vullnetarit të shprehë gjithçka që dëshiron në lidhje me vizatimin.
 - g) Pyete nëse vizatimi ka ndonjë mesazh – cili do të ishte ai mesazh?
 - h) Pyete nëse ka edhe ndonjë gjë tjetër që dëshiron të ndajë në lidhje me vizatimin.
 - i) Falënderoje që ishte i/e gatshëm për të ndarë gjërat në lidhje me vizatimin e tyre.

Shënim: Mund të bëni komente të përgjithshme për trajtat, ngjyrat dhe hijezimet e përdorura në vizatim.

Kini kujdes që:

- Të SHMANGNI çfarëdo deklarate gjykuese për cilësinë e vizatimit apo nëse ju pëlqen apo jo. Pra, shmangni komentet e tilla si “është e bukur”, “është e mirë” (është vështirë që të zbatohen komentet e tilla për të gjithë fëmijët dhe mund të jetë dekurajuese për fëmijët të cilët nuk ka marrë komente të tilla vlerësuese pozitive e subjektive – puna e tyre mund të jetë njësoj shprehëse por mund të jetë më pak e kënaqshme në kuptimin estetik për syrin tuaj)
- Të MOS e interpretoni vizatimin
- Të MOS e analizoni vizatimin
- Të MOS pretendoni që e dini trajtën – nëse shihni një objekt drejtkëndësh që ju mendoni se është një tavolinë – ju pyesni se çfarë trajtë është ajo dhe mos pretendoni se ju e dini se si personi e shpreh veten e tij – mund të mos jetë tavolinë fare por një libër (për shembull)
- Të MOS pretendoni se e dini se cila pjesë e vizatimit është më e rëndësishmja – vetëm artisti mund ta dijë një gjë të tillë.

Puna e personit i cili bën intervistën është të parashtrojë pyetje për t’i krijuar mundësi personit të ndajë atë që dëshiron të ndajë. Ju nuk duhet ta përdorni intervistën për të nxjerrë informacione nga fëmija por – si një lloj efekti anësor – mund të mësoni më shumë për mjedisin në të cilin jeton fëmija dhe se si ata e shohin botën (që rastësisht mund të jetë e dobishme për ju në cilësinë e mësuesit). Qëllimi i ushtrimit është t’ju ndihmojë për krijimin e një mjedisi të sigurt për fëmijën që t’ju tregojë sa më shumë apo sa më pak për vizatimin dhe sesi kjo ndërlidhet me jetën e tyre, ashtu siç duan ata. Duhet të jeni të vetëdijshëm se disa fëmijë nuk kanë shumë për të thënë dhe ju duhet ta respektoni këtë gjë.

Vullnetari do të zhvillojë aftësitë e komunikimit dhe aftësitë për të shprehur vetveten, vetëvlerësimin dhe vetë-respektin.

Personat e tjerë që dëgjojnë do të mund të zhvillojnë aftësi dëgjimi, aftësi empatie, duke e parë që, megjithatë, jeta e këtij personi ndoshta nuk ndryshon edhe aq nga e tyra – duke e përforcuar konceptin e humanizmit të përbashkët.

Lejoni 5 – 10 minuta për intervistë.

7. Nëse koha lejoni, bëni më shumë se një intervistë.
8. Lejoni ca minuta kohë që grupet e vogla të mbledhen dhe pajtohen rreth përgjigjeve në pyetjet e parashtruara. (5 min)
9. Bëni bashkë të gjitha grupet dhe pyeteni çdo grup t’i ndajnë me të tjerët mendimet e tyre. Ndihmoheni grupin t’i vërejë pikat e identifikuara më sipër.

Përgjigjet në pyetjet për grupet e vogla të renditura në pikën 5 më sipër

- i) Hapat identifkohen në pikën 6 më sipër
- ii) Bëni pyetje të hapura, jo pyetje të drejtpërdrejta.
- iii) Bëni komente të hapura, jo gjykuese
- iv) Personi do të përgjigjej normalisht duke ndarë hollësi personale nga jeta/gjendja e vet, dhe duke ndarë ndjenja për situatën, gjë që i lejon të reflektojë në mënyra të reja
- v) Këto identifkohen te Arsyetimi dhe Rezultatet e Mësimnxënies më sipër
- vi) Këto identifkohen në fund të pikës 6 më sipër
- vii) Këto identifkohen në fund të pikës 6 më sipër

Bëni një diskutim me të gjithë grupin rreth aktivitetit dhe se si mund të përdoret në klasë.

Është e rëndësishme që tema e përzgjedhur të shihet si një nga shumë prej tyre që mund ta përdorin me fëmijët që të bëjnë vizatime që çojnë në këtë lloj shkëmbimi. Gjatë vitit shkollor, çdo fëmijë do të mund të ketë mundësinë të flasë për një vizatim (fotografi). Ndërtimi i vetëvlerësimit pozitiv është i rëndësishëm për të gjithë fëmijët në klasë – zakonisht, fëmijët nga pakicat kanë vetëvlerësim të ulët, veçanërisht nëse i nënshtrohen ngacmimit në shkollë. Ndërtimi i vetëvlerësimit në mesin e fëmijëve shumicë është po aq e rëndësishme – me qëllim që ata mos ta përvetësojnë ngacmimin si mjet për të ndërtuar vetëvlerësim, ashtu siç është nevoja për të ndërtuar empati ndërmjet fëmijëve, që mund të ndodh përmes përdorimit të kësaj mënyre të pyetjes dhe shkëmbimit të hapur nga nxënësit.

b) *Ditari i mirënjohjes*

Arsyetimi: Të ndjehesh mirënjohës dhe të gjenerosh mirënjohje është një mënyrë për të krijuar vetëvlerësim pozitiv. Studimet tregojnë se njerëzit që janë mirënjohës ka më pak gjasë të jenë ziliqarë ndaj të tjerëve dhe nuk e kanë të nevojshme t'i ngacmojnë të tjerët. Gjithashtu, është treguar se mirënjohja apo falënderimi është një sjellje që mund të mësohet lehtësisht. Prandaj, ky aktivitet zhvillon ndjenjën e mirënjohjes.⁴

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të mësosh të ndjehesh mirënjohës për gjërat e mira në jetë
- Të çmosh që ndjenja e mirënjohjes për gjërat e mira në jetën tuaj mund të ju ndihmojë të ndjeheni më mirë për gjendjen jetësore dhe kështu të shtoni vetëvlerësimin.

4 Shih, për shembull <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/1467-9450.00041/abstract>

Mjetet: Fletore e vogël për çdo pjesëmarrës, një copë e vogël çokollatë cilësore (ose frut i shijshëm) për person.

Koha: 10 – 15 min

Udhëzime:

1. Prezantoni arsyetimin dhe sqaroni se si mbajtja e një ditari të mirënjohjes, dhe të krijosh hapësirë kohore për fëmijët në shkollë të mbajnë ditar të mirënjohjes mund të pakësojë nevojën për t’i detyruar dhe ngacmuar fëmijët tjerë.
2. Për t’i dhënë një ide paraprake të këtij aktiviteti, shpërndani nga një copë të vogël çokollate cilësore. Thuajuni pjesëmarrësve që nuk mund ta hanë çokollatën menjëherë (!). Thuajuni ta shikojnë çokollatën, mund madje t’i marrin erë. Bëjini të hapen gjatë pranimit të kësaj cope çokollate, të cilën do ta shijojnë dhe çmojnë çdo moment gjatë ngrënies. Më pas, thuajuni që mund ta hanë çokollatën por sa më ngadalë që është e mundur (5 min)
3. Pasi ta kenë ngrënë çokollatën, shpërndani fletoret dhe informojini pjesëmarrësit që kjo fletore u shërben për të shënuar të gjitha gjërat për të cilat janë mirënjohës çdo ditë. Ndoshta do të kenë dëshirë ta zbukurojnë. Mund të fillojnë me gjëra të thjeshta, një trup të shëndoshë, mendje të ndritur, ushqim, edukim, dritë dielli. Thuajuni se është e rëndësishme të jenë sa më specifikë. Për shembull, ‘Jam mirënjohës për mënyrën se si dielli shkëlqen në lumin afër shtëpisë sime dhe reflekton në dritë’, në vend të ‘Jam mirënjohës për dritën e diellit.’ (5 - 10 min)
4. Theksoni se po të përdoret në klasë rregullisht, ky aktivitet mund të përfshihet në mësimet gjuhe, duke e pasuruar fondin e fjalëve; për ta frymëzuar njëri-tjetrin, fëmijët mund të shkëmbejnë gjëra për të cilat janë mirënjohës.

c) *Në klasën tonë*

Arsyetimi: Ky aktivitet ndërton aftësinë e dhënies dhe marrjes së informacionit (feedback) pozitiv dhe kështu ndihmon të krijohen kontakte të mira ndërmjet fëmijëve, në mënyrë që ata ta vlerësojnë veten dhe njëri-tjetrin dhe të shohin që të gjithë kanë cilësi të mira. Dhënia dhe marrja e informacionit pozitive ndihmon në ndërtimin e vetëvlerësimit pozitiv, meqënëse, duke marrë informacion pozitiv ne mësojmë që nëse njerëzit e tjerë i çmojnë cilësitë apo tiparet e mira që kemi, atëherë ndoshta edhe ne mund ta bëjmë një gjë të tillë. Po ashtu, dhënia e informacionit pozitiv është aftësi e rëndësishme për t’u mësuar, sepse mësojmë t’i

çmojmë cilësitë e mira që kanë të tjerët dhe të ndërmarrim rrezikun t'ua themi pa e diskriminuar veten në asnjë mënyrë gjatë procesit. Dhënia dhe marrja e informacionit pozitiv mund të jetë sfiduese në disa kultura – megjithatë është një aftësi e rëndësishme për të gjithë dhe, në përgjithësi, njerëzit e vlerësojnë kur u flisni për gjërat që ju pëlqejnë tek ata.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të mësosh të shprehësh atë që e çmon lidhur me veten dhe të tjerët
- Të mësosh të pranosh atë që njerëzit e tjerë e shohin si cilësi të mirë të tyre
- Të kuptosh që çdonjëri ka cilësi të mira dhe njerëzve zakonisht u pëlqen të marrin këtë lloj informacioni

Të nevojshme: Letër, laps me ngjyrë, lapsa ngjyre dylli

Koha: 30 min

Udhëzime:

1. Udhëzojini fëmijët të vizatojnë rreth duarve të njëri-tjetrit. Shpjegojuni që këto duar përfaqësojnë diçka që atyre u pëlqen tek vetja dhe te njëri-tjetri. Në mes, ata duhet të shkruajnë emrin e tyre dhe diçka që u pëlqen tek vetja. (5 min)
2. Më pas, ata duhet t'i përdorin gishtërinjtë që i kanë vizuar për fëmijët tjerë në klasë. Ata duhet të shkruajnë emrin e tyre dhe cilësinë që u pëlqen tek ai fëmijë. Duhet t'i inkurajoni fëmijët që të shkruajnë jo vetëm emrat e shokëve të afërt, por edhe të shokëve të klasës që nuk i njohin aq mirë. (Nëse dëshironi t'ua lehtësoni punën, mund t'i lejoni të përfshijnë te duart njerëz të tjerë si për shembull të afërmit). Nëse dëshironi t'i nxisni më tej fëmijët, inkurajojini ata të gjejnë cilësi të mira për fëmijët që nuk i njohin aq mirë. Ata mund gjithashtu të kenë dëshirë t'i zbukurojnë duart. (10 – 15 min)
3. Pasi ta kenë përfunduar punën, vendosini në mur të gjitha punimet që të gjithë t'i shohin ato dhe shihni se si janë të lidhur të gjithë njëri me tjetrin. Gjithashtu, ju mund të diskutoni për cilësitë që ka secili prej tyre – jo të gjithë do t'i pëlqejnë cilësitë e njëjta tek të tjerët. (5 – 10 min)

d) *Të ndihmosh shokët*

Arsyetimi: Ky aktivitet fokusohet në ndërtimin e vetëvlerësimit përmes procesit të afrimit të personit tjetër me anë të shkrimit të një letre. Vetëvlerësimi i shëndoshë ndërtohet përmes shkëmbimit të situatave personale, vlerësimit të gjërave të mira që ndodhin, dhe marrjes dhe dhënies së përkrahjes kur ka nevojë për një gjë të tillë. Ky aktivitet duhet të bëhet së pari kur gjërat shkojnë mbarë e mirë, në mënyrë që të zhvillohen aftësi të cilat mund të zbatohen më vonë, kur të kemi zhvilluar aftësitë e nevojshme për t'u përballur me situata më sfiduese. Me kalimin e kohës, vlen të përsëritet ky aktivitet për situata të ndryshme – në mënyrë që vetëvlerësimi pozitiv të mund të ndërtohet hap pas hapi. Aktiviteti ndihmon në krijimin e vetëvlerësimit, sepse u jep pjesëmarrësve kapacitetin që të ndihmojnë të tjerët – qoftë kjo edhe në imagjinatën e tyre – si dhe u jep një këndvështrim të asaj që është duke ndodhur në jetën e tyre. Aktiviteti mund, gjithashtu, t'i ndihmojë pjesëmarrësit të shohin se kanë aftësi dhe përparësi që vlen të zhvillohen me tej dhe të ndërtojnë ndjenja lidhjeje me botën e gjerë.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Për të ndërtuar një vetëvlerësim të shëndoshë përmes afrimit dhe ndihmës ndaj një personi tjetër
- Të njohësh që edhe njerëzit tjerë kanë situata të ndryshme me të cilat ballafaqohen dhe se përmes afrimit të gjithë mund ta ndihmojnë dhe përkrahin njëri-tjetrin
- Të ndjesh një ndjenjë lidhjeje përmes shkrimit të letrave
- Të krijosh aftësi komunikimi dhe fjalor në të shkruar për një mori situatash

Mjetet: Letër, lapsa

Koha: 25 -30 min

Udhëzime:

1. Sqaroni që ky aktivitet është hartuar ndihmojë pjesëmarrësit të ndërtojnë vetëvlerësim pozitiv duke zhvilluar një perspektivë më të gjerë se ajo që ka një njeri i vetëm. Prosesi që do të demonstrohet përmes këtij aktiviteti mund të përdoret gjatë kohës për të ndërtuar vetëvlerësim pozitiv, për të ndihmuar në situata të ndryshme –për t'i përkrahur njerëzit që përballen me situata sfiduese ose të vështira. (5 min)
2. Ftojini pjesëmarrësit t'i mbyllin sytë dhe të kujtojnë një situatë të lumtur të kohës së fundit, një sukses i vogël, ose diçka që ka ecur mbarë. Duhet ta kujtojnë sa më gjallërisht që është e mundur.

Pyet:

- Kush tjetër ka qenë i përfshirë në situatë? – anëtarë të familjes? Në shkollë? etj.
 - Ku kanë qenë?
 - Ftojini që të kujtojnë çfarëdo ndjesie si erën, zërat, ose si janë ndier fizikisht gjatë kohës kur ka ndodhur, etj. (5 min)
3. Thuajuni pjesëmarrësve se duhet të imagjinojnë që kanë një shok që ka përjetuar, ose do të përjetojë tani, saktësisht të njëjtën situatë ose një situatë shumë të ngjashme.
 4. Ftojini t'i shkruajnë një letër këtij shoku. Çfarë do të dëshironin të dinte ky person, në mënyrë që t'ju ndihmonte ta vlerësojë situatën dhe të marrë më të mirën nga ajo? (10 min)
 5. Sqaroni se për shkak se bota është aq e madhe dhe se në të ka aq shumë (njerëz) fëmijë (me miliona) ka shumë mundësi që ekziston dikush, ndokund në botë, që është duke e përjetuar të njëjtën gjë ose një situatë shumë të ngjashme në atë çast.
 6. Tani thuajuni ta lexojnë letrën sikur të ishin ata që kanë marrë letrën nga shoku i tyre, i cili i njeht shumë mirë dhe që e di saktësisht se si ndjehen. (5 min)
 7. Mblidheni grupin sërish bashkë dhe pyetini se çfarë mendojnë për ushtrimin. Pyetini për informacione të reja për situatën e tyre. Mund të ftoni një ose dy pjesëmarrës që t'i lexojnë ose t'i ndajnë letrat e tyre me të tjerët. (5 min)

Alternativa:

8. Zgjeroheni ushtrimin –tani ose më vonë – duke e përsëritur shkrimin e letrës, por, këtë herë, duhet t'i shkruajnë shokut për një situatë që është një ngjarje nga përditshmëria – sot në shkollë, në kohë pushimi, në shtëpi me familjen, etj.
9. Në një kohë tjetër të mëvonshme, mund ta përsëritni ushtrimin me pjesëmarrësit ku ata do të shkruanin për një situatë që është e rëndësishme por pak a shumë neutrale, ose për një që është e vështirë por të cilën e kanë tejkaluar mjaft mirë, ose për një situatë jo shumë sfiduese.
10. Mund të theksoni se mund t'i shkruajnë shokut kurdo që dëshirojnë dhe se ky proces i shkrimit ose marrjes së letrës nga shoku imagjinari mund të jetë i dobishëm kur të përbalen me situata të vështira ose sfiduese.

Shënime:

- Ky aktivitet mund të përdoret brenda orëve të mësimit në gjuhë amtare për të ndihmuar në ndërtimin e fjalorit dhe aftësisë së shkrimit, si dhe vetëvlerësimit që është fokus i këtij aktiviteti.
- Është e rëndësishme të ndërtohet ky vetëvlerësim pozitiv ngadalë dhe jo të fokusohemi direkt në situata sfiduese që mund t'i çojnë pjesëmarrësit në përjetimin sërish të një situata që ka qenë jashtëzakonisht sfiduese; kjo nuk do ta ndihmonte procesin aspak.
- Mund të jetë e dobishme për pjesëmarrësit që t'i ruajnë letrat që i shkruajnë në mënyrë që t'i lexojnë përsëri në të ardhmen kur mund t'ju duhen.

PJESA E

Pjesa Përmbyllëse

Në pjesën përmbyllëse të udhëzuesit ka dy module – së pari një modul që u lejon pjesëmarrësve të reflektojnë për çfarë kanë mësuar dhe të identifikojnë se si mund ta zbatojnë në praktikë atë që kanë mësuar në klasë . Moduli përfundimtar prezanton disa aktivitete përmbyllëse të përshtatshme.

15. Planifikimi

a) *Planifikimi i veprimeve*

Arsyetimi: Qëllimi i këtij aktiviteti është t'i ndihmojë pjesëmarrësit t'i maksimizojnë përfitimet nga trajnimi. Ai është planifikuar t'i ndihmojë të zbatojnë atë që kanë mësuar në mënyrën e tyre. Kryesisht është menduar për përdorim me mësues.

Rezultatet e mësimnxënies :

- Të identifikojnë atë që kanë mësuar dhe si mund të zbatohet në praktikë.
- Të identifikojnë hapat që duhet të ndërmerren

Mjetet: Letër, lapsa

Koha: 15 – 20 min

Udhëzime:

1. Pyetini pjesëmarrësit çfarë mendojnë se kanë mësuar me vlerë gjatë trajnimit? Mund të jetë e dobishme që të përsëriten shkurtimisht aktivitetet e bëra.
2. Sqaroni që hapat e ardhshëm janë që të zbulohet se si këto gjëra mund të zbatohen në mjedisin ose rrethin e tyre
3. Duke punuar individualisht, pjesëmarrësit duhet të shkruajnë:
 - Gjërat që kanë mësuar dhe aktivitetet që mund t'i përdorin
 - Gjërat që do të dëshironin t'i ndryshonin si rezultat i asaj që kanë mësuar
 - Çfarë hapash duhet të ndërmarrin?
 - A duhet të përfshihet edhe dikush tjetër? Si mund të përfshihen?
 - Kur mund të bëhet kjo?

Nëse është e mundur, mund të bëjnë një plan të hollësishëm me afate kohore.

b) *Detyrë shtëpie dhe vazhdimi*

Si detyrë shtëpie nga ky kurs është që çdo mësues, së bashku me klasën, të bëjnë një poster të punës së re që bëjnë në klasë si rezultat i këtij trajnimit, gjë që duhet të reflektojë ndryshimet që ndodhin në shkollë.

16. Aktivitetet përmbyllëse

Si mënyra të përshtatshme të përmbylljes së grupit paraqiten tre aktivitete alternative. Si të përshtatshme, mund të bëhen një ose më shumë aktivitete.

a) *Urimet më të mira*

Arsyetimi: Qëllimi është të ndihmohen pjesëmarrësit të çmojnë gjërat e mira që kanë në jetë dhe të nxisin qëndrimin e ndarjes së gjërave të mira. Psikologët kanë treguar që sa më shumë i çmojmë gjërat e mira që kemi aq më mirë do të ndjelemi dhe njëkohësisht do të ketë shumë më pakë gjasë t'u bëjmë dëm të tjerëve.⁵

Rezultatet e mësimnxënies:

- T'i identifikojnë qëllimet e mira që dëshirojmë për veten dhe të tjerët
- Të ç'mojnë që edhe njerëzit e tjerë ua dëshirojnë të mirën të tjerëve

Shënim: Ky aktivitet nuk është i përshtatshëm për përdorim me fëmijë në moshë shumë të vogël.

Mjetet e nevojshme: Letër dhe laps

Koha: 20 - 30 min

Udhëzime:

1. Ftojini pjesëmarrësit t'i mbyllin sytë dhe drejtoni një reflektim të shkurtër të udhëhequr:
Ftojini të mendojnë për njerëzit që kujdesën për ata, që i duan, dhe që kanë mendim të mirë për ata. Reflektoni mbi faktin se sa të rëndësishëm jeni për njerëzit rreth jush dhe në botë. Lejojini vetës të mbusheni me tërë këtë dashuri që e ndjeni. Mbushuni me këtë dashuri e pastaj shpërndajeni tek të tjerët që jua duan të mirën dhe kujdesën për ju, si dhe më pas shpërndajeni tek të gjithë njerëzit kudo në botë. (3 min)
Tani, hapini sytë
2. Pyeteni grupin, nëse do të kishte një gjë të cilën do t'ia dëshironin vetës, çfarë do të ishte ajo?
3. Pyeteni grupin, nëse do të kishte një gjë që do t'ia dëshironin tërë botës dhe njerëzve, çfarë do të ishte ajo.

5 Shih për shembull <http://www.emeraldinsight.com/journals.htm?articleid=1760846&show=abstract>

4. Jepuni kohë pjesëmarrësve t'í shkruajnë apo vizatojnë dëshirat e tyre . (5 min)
5. Ftoni pjesëmarrësit t'í ndajnë me të tjerët të gjitha dëshirat që kanë – personale dhe të përgjithshme. (10 min)
6. Pyetini pjesëmarrësit pse mendojnë që u bë ky aktivitet dhe si lidhet ai me trajnimin?
Sqaroni se duke krijuar një ndjenjë pozitive ne krijojmë dhe përkrahim mendime pozitive në trurin tonë. Sqaroni që psikologët kanë treguar se modele (mendime) të tilla të krijuara në tru e ulin nevojën për t'í fajësuar ose sakrifikuar të tjerët⁶ (5 min)

Shënim: Në klasë, ky aktivitet mund të bëhet herë pas here me qëllim që këto ndjenja të vullnetit të mirë dhe dëshirave të mira ndaj vetës dhe të tjerëve të zhvillohen më tej.

b) *'Kaloje gurin tek tjetri'*

Arsyetimi: Si aktivitet përmbyllës, pjesëmarrësit shkëmbejnë ca fjalë për ta përmbyllur përvojën e tyre .

Rezultatet e mësimnxënies:

- T'u flasësh të tjerëve për ndjenjat tuaja
- T'í dëgjosh të tjerët me respekt
- Të shprehësh shkurtimisht se si ndjehesh

Mjetet: Një gur ose objekt tjetër të vogël që mund t'ju kalohet të tjerëve lehtësisht.

Koha: 30 min

Udhëzime:

1. Sqaroni që ky është aktiviteti i fundit që do të bëjë grupi dhe se kjo është mundësia për komentet e tyre të mundshme përmbyllëse. Theksoni që çdonjëri prej tyre ka rreth një minutë kohë të flasë dhe se ju do t'ua rikujtoni këtë gjatë nëse e tejkalojnë kohën. Rikujtojuani që ta dëgjojnë njëri-tjetrin me kujdes dhe se vetëm personi që ka gurin mund të flasë.
2. Kalojeni gurin tek personi tjetër dhe lejojini kohë çdonjërit të flasë.

⁶ Shih për shembull http://www.heartmathbenelux.com/doc/McCratyael_article_in_integral_review_2009.pdf

c) *Përfundimet*

Arsyetimi: Mënyrë e shkurtë dhe e thjeshtë për ta përmbyllur grupin.

Rezultatet e mësimnxënies: Të krijosh një mënyrë të thjeshtë e të shkurtër për ta përmbyllur punën e grupit.

Mjetet: Hapësirë për të qëndruar.

Koha: 5 min

Udhëzime:

1. Ngrihuni në këmbë dhe bëni një rreth. Ftojini grupin që të merr pak kohë dhe të shikojë rrethin e krijuar dhe të gjejë një mënyrë që ta njohin e pranojnë njëri-tjetrin në përvojën e ndarë bashkërisht.
2. Ftojini grupin të kthehet me fytyrë prapa, theksoni që ata tani mund ta ndjejnë praninë e çdonjërit rreth tyre ndonëse nuk mund t'i shohin.
3. Tani ftojini të gjithë të bëjnë një hap tutje nga rrethi. Mund të shpallni që puna e grupit përfundoi dhe se çdo person aty do të marrë me vete diçka nga kjo përvojë.

Shtojca 1

Informacion mbështetës në lidhje me diskriminimin e romëve⁷



Përgatitur nga: Manjola Veizi

Manjola drejton “Qendrën për të Drejtat e Grave Rome në Shqipëri” dhe është aktiviste rome qysh prej më shumë se dhjetë vitesh. Manjola ka kryer studimet e nivelit Bachelor në drejtësi dhe është shumë aktive në një varietet çështjesh që i përkasin romëve si: strehimi, legalizimi, gratë rome, çështje të familjes, të drejtat e romëve etj. Ajo është përfshirë aktivisht në iniciativa të ndryshme të ndërmarra nga PNUD, SOROS, OSBE, ERRC të cilat synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mbrojtjen e të drejtave të romëve.

Historik

Romët formojnë një prej pakicave më të mëdha në Evropë. Sipas një studimi të bërë nga *Amnesty International* në 2010, në Evropë ka rreth 10 milionë romë dhe rreth 80% e popullsisë rome në Evropë jeton në shtete anëtare ose kandidatë të BE-së.

⁷ Aktiviteti që shoqëron tekstin mund të gjendet në Seksionin 13

Romët janë ndër grupet më pak të arsimuara në rajon. Shumë romë në Evropë janë tejet në disavantazh për shkak të nivelit të ulët të shkrim-leximit apo shkollimit të lënë përgjysmë. Ka një hendek të madh midis nivelit arsimor të romëve dhe atij të pjesës më të madhe të popullsisë.⁸ Pak fëmijë romë e përfundojnë arsimin e detyrueshëm, dhe rrjedhimisht, ata që përfundojnë shkollën e mesme janë shumë pak. Numri i fëmijëve romë të regjistruar në sistemin e formimit profesional (VET) dhe arsimimin tretësor është i papërfillshëm.

Në vitin, UNDP, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian bënë një sondazh me 750 familje rome dhe 350 familje jorome që jetojnë në ose pranë komuniteteve rome në 12 shtete, përfshirë Shqipëri, Bosnje Hercegovin, Kroaci, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia. Gjetjet e sondazhit tregojnë se komunitetet rome janë shumë prapa sa i takon shkollimit⁹:

- Mesatarisht, vetëm një prej dy fëmijëve romë të sondazhit ndjekin kopshtin ose parashkollorin.
- Vetëm 15 përqind e të rinjve romë kanë përfunduar ciklin e lartë apo shkollë profesionale.

Gjetjet e sondazhit¹⁰, një përzgjedhje e të cilit është riprodhuar në tabelën më poshtë, tregojnë për gjendjen e romëve në krahasim si me fqinjët e tyre jo-romë dhe me komunitetet rome në rajon.

<u>Shteti</u>	<u>Njohuritë shkrim-lexim</u> (mosha 16+)		<u>Regjistrimi në shkollë</u> (mosha 7-15)		<u>Regjistrimi në shkollë</u> (mosha 16-19)	
	Rom	Jo-rom	Rom	Jo-rom	Rom	Jo-rom
Shqipëria	65%	95%	48%	91%	13%	60%
Bosnjë Hercegovina	82%	97%	61%	96%	15%	72%
Kroacia	84%	99%	87%	93%	31%	77%
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	83%	96%	74%	90%	27%	65%
Mali i Zi	73%	99%	55%	94%	13%	61%
Serbia	85%	98%	80%	95%	25%	71%

8 Amnesty International 2010

9 UNDP/World Bank/EC regional Roma survey 2011 [Surveji rajonal për Romët 2011].

10 Gjetjet e sondazhit mund t'i shkarkoni në lidhjen <http://europeandcis.undp.org/data/show/D69F01FE-F203-1EE9-B45121B12A557E1B..>

Sipas studimeve të kryera kohët e fundit, disa shkaqe për rezultatet e ulëta të shkollimit të romëve janë:¹¹

- Mungesa e shërbimeve cilësore arsimore në fëmijëri të hershme
- Mungesa e regjistrimit të lindjeve
- Varfëria dhe përjashtimi social
- Pengesa gjeografike dhe financiare
- Izolimi në shkolla të posaçme
- Mjedis jomiqësor në shkollë dhe klasë
- Pengesa të gjuhës
- Program shkollor jo shumëkulturor
- Paragjykim dhe mosdashje

Trajtimi i diskriminimit dhe ngacmimit në klasë

(Shënim: ky aktivitet është hartuar në bashkë-autorësi me Ruth Friedman)

Ky modul synon të nxjerrë në pah vështrësi me të cilat përballen fëmijët romë në shkolla të përziera dhe të rrisë ndërgjegjësimin ndaj dukurisë së diskriminimit dhe izolimit.

Ky modul përdor veprimtari për t'i ndihmuar mësuesit të kuptojnë se si sjellja e tyre luan një rol të rëndësishëm për përmirësimin në nivelin e edukimit të fëmijëve romë dhe duke i inkurajuar motivimi i fëmijëve rritet, duke ndikuar direkt në rritjen e nivelit të regjistrimit dhe frekuentimit të shkollës nga fëmijët romë.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të kuptohet që shpesh mund të ndodhë që pa vetëdije fëmijët romë të diskriminohen, dhe të reflektohet për mënyra të efektshme për qasjen ndaj fëmijëve romë në klasa;
- Të dallohet /reflektohet mbi qasjet pozitive dhe negative të përdorura në praktikë;
- Të reflektohet për mënyra të ndryshme se si mësuesit mund të ndihmojnë fëmijët romë të kapërcejnë pengesat që hasin;
- Të ndihmojë për krijimin e një atmosfere besimi midis mësuesve, fëmijëve romë dhe prindërve;

11 UNICEF, 2011, The Right of Roma Children to Education: Position Paper. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States (CEE/CIS). [E drejta e fëmijëve romë për edukim]

Arsyetimi: Në rastet e studimit më poshtë, jepen raste nga jeta reale që ilustronjë vështirësitë, disa herë të panjohura, të fëmijëve dhe prindërve romë, në përpjekje për të frekuentuar shkollën apo kur janë në klasë. Është e rëndësishme të kuptohen këto vështirësi dhe të bëhen përpjekje për të gjetur zgjidhje praktike për këto situata. Gjithashtu, është e rëndësishme që të mësohet se jo gjithçka është ashtu si duket si dhe për të përmirësuar aftësitë e dëgjimit dhe për të vënë në provë durimin e mësuesit apo asistentit në shkollë. Padyshim, edhe prindërit romë kanë një rol të rëndësishëm, po kjo do të diskutohet te veprimtaritë e përkruara te Shtojca II.

Kërkesat:

- Udhëzuesi me raste studimi praktike (shih më lart, pjesëmarrësit marrin një rast për grup)

Koha: 90 min

Udhëzime:

1. Informojini pjesëmarrësit për çfarë bën fjalë ky ushtrim. Informojini se qëllimi është të ndihmojë mësuesit të shohin këto raste për të kuptuar më mirë se sa komplekse janë dhe t'i ndihmojë të gjejnë zgjidhje. (5 min)
2. Shpjegojuni pjesëmarrësve procesin që do të ndjekin duke marrë një nga rastet si shembull, përdorni rastet dhe pyetjet për të analizuar situatën dhe për të nxjerrë zgjidhje të mundshme. Lejoni kohë të mjaftueshme për pyetje nga pjesëmarrësit për të siguruar që kuptohet si duhet. (15 min)
3. Ndajini pjesëmarrësit në grupe. Shpërndajuni rastet. (një rast për grup)
4. Kërkojuni pjesëmarrësve (mësuesve) të analizojnë situatën e dhënë dhe të identifikojnë jo vetëm veprime administrative por edhe vetjake dhe të personalizuara për të reaguar në situatën e dhënë. (20 min)

Përdorni pyetjet e mëposhtme për të zhvilluar analizën:

- Si është situata e përgjithshme?
 - Nga këndvështrimi i secilit personazh në situatë– shpjegoni si mendoni se e shohin ata situatën (secili anëtar i grupit do të luajë rolin e një personi/grupi të përfshirë në rastin e studimit)
 - Cilat mendoni janë nevojat e secilit person/grup?
 - Nevojat e cilit po plotësohen? A ka mënyra të tjera për t'i plotësuar këto nevoja?
 - Nevojat e cilit nuk po plotësohen? Si mendoni se mund të plotësoheshin?
 - A mendoni se po shkelen të drejta? Cilat të drejta? Dhe të kujt?
 - Sipas mendimit tuaj, çfarë (ose kush) duhet të ndryshojë në këtë situatë? Duhet të mendoni në mënyrë sa më kreative – të gjitha ndryshimet e mundshme mund të përfshihen në këtë fazë
 - Ku mendoni se ndryshimi është i mundur? (disa prej ndryshimeve ideale që do të dëshironit mund të mos jenë realiste
 - Çfarë mund të bëhet për të ndryshuar situatën, nga kush?
 - Çfarë mund të bëni (nëse kjo situatë do të ndodhte në shkollën tuaj) për të ndihmuar të siguroheni se këto ndryshime mund të zbatohen? (Hartoni një planveprimi).
5. Mblidheni grupin bashkë dhe secili prej grupeve të vogla të paraqesë zgjidhjen e tyre apo zgjidhje të mundshme. Ftojini pjesëmarrësit e tjerë të japin komentet e tyre (10 min për rast)
6. Në mbyllje, pyeteni grupin se çfarë pika të përgjithshme kanë mësuar? (5 min)

Pyetjet

Si është situata e përgjithshme?

Nga këndvështrimi i secilit personazh në situatë– shpjegoni si mendoni se e shohin ata situatën (secili anëtar i grupit do të luajë rolin e një personi/ grupi të përfshirë në rastin e studimit)

Cilat mendoni janë nevojat e secilit person/grup?

Nevojat e cilit po plotësohen? A ka mënyra të tjera për t'i plotësuar këto nevoja?

Nevojat e cilit nuk po plotësohen? Si mendoni se mund të plotësoheshin?

A mendoni se po shkelen të drejta? Cilat të drejta? Dhe të kujt?

Sipas mendimit tuaj, çfarë (ose kush) duhet të ndryshojë në këtë situatë? Duhet të mendoni në mënyrë sa më kreative – të gjitha ndryshimet e mundshme mund të përfshihen në këtë fazë

Ku mendoni se ndryshimi është i mundur? (disa prej ndryshimeve ideale që do të dëshironit mund të mos jenë realiste

Çfarë mund të bëhet për të ndryshuar situatën, nga kush?

Çfarë mund të bëni (nëse kjo situatë do të ndodhte në shkollën tuaj) për të ndihmuar të siguroheni se këto ndryshime mund të zbatohen? (Hartoni një planveprimi).

Personazhet e rasteve të studimit:

	Personi 1	Personi 2	Personi 3	Personi 4
Si e sheh personi situatën?				
Cilat janë nevojat e këtij personi?				
A po plotësohen nevojat e tyre? P/J				
Si mund të plotësoheshin nevojat e tyre?				
A po shkelen të drejtat e tyre?				
Cilat të drejta?				
Çfarë mund të bëjë ky person për të ndryshuar situatën?				

Tani, ju lutem shprehni rezultatin/et tuaja të preferuara për të ndryshuar situatën
.....
.....

Nëse kjo situatë do të ndodhte në shkollën tuaj, çfarë do të bënit që të ndodhte ndryshim? (Hartoni një planveprim).

Raste studimi (të dhëna nga Manjola Vezi):

Rasti I

Maria sapo ka mbushur shtatë vjeç. Janë ditët e fundit të gushtit dhe prindërit e saj kanë dëshirë ta regjistrojnë në shkollën afër vendbanimit të tyre. Bashkë me Marinë, ata shkojnë tek drejtori i shkollës për ta regjistruar. Ditën e parë, u thuhet të vijnë të nesërmen, pasi do të mbahet një takim i mësuesve. Ata shkojnë të nesërmen, ndërsa një asistent u thotë të dorëzojnë certifikatën e lindjes dhe librezën e vaksinimit të Marisë.

Prindërit e Marisë shkojnë tek njësia e qeverisjes vendore për të marrë certifikatën e lindjes, por zyrtari atje u thotë që nuk mund t'ua japë, për shkak se nuk kanë paguar taksën e shtëpisë. Ata kanë vështirësi të sigurojnë librezën e vaksinave të Marisë, sepse kanë qenë në udhëtime dhe ajo nuk i ka ndjekur të gjitha fazat e vaksinimit. Kthehen sërisht tek drejtori dhe e informojnë për vështirësitë që kanë hasur.

Rasti II

Enea është shtatë vjeç. Ai është në klasën e parë, po nuk ka ndjekur asnjë vit të arsimit parashkollor, e tani po përballet me vështirësi në të kuptuarit e mësimëve. Enea shpesh vjen në shkollë pa kryer detyrat e shtëpisë. Mësuesi ka folur me prindërit, por ata i kanë thënë që janë analfabetë, ndaj nuk mund ta ndihmojnë me detyrat. Fëmijët e tjerë nuk duan të ulen në të njëjtën bankë me të, sepse ai është rom. Enea gjithmonë kthehet në shtëpi duke qarë dhe nuk dëshiron të shkojë në shkollë më.

Rasti III

Emanueli është një djalë energjik rom në klasën e tretë. Ai nuk është i mirë në detyra të shtëpisë, por i pëlqen shumë muzika. Ai ka dëshirë të këndojë dhe është shumë aktiv gjatë orës së muzikës. Ai i bie mirë violinës, të cilën ia ka mësuar gjyshi. Në kuadër të festimeve të Vitit të Ri, shkolla do të organizojë një koncert. Do të ftohen personalitete publike të mirënjohura. Mësuesi ka angazhuar 5 nxënës nga klasa që të përgatiten për ta përfaqësuar klasën. Emanueli nuk është angazhuar, pavarësisht se mësuesi i kishte thënë njëherë që është më i miri në orën e muzikës. Ai shkoi në shtëpi dhe u tregoi prindërve atë që kishte ndodhur.

Ata i thanë djalit që nuk ishte zgjedhur për shkak se është rom, si dhe pa marrë parasysh se sa i mirë është, nuk do ta trajtojnë në mënyrë të drejtë. Që atë ditë, kënga e Emanuelit nuk është dëgjuar më as gjatë pushimeve e as në orën e muzikës.

Rasti IV

Alesia, një vajzë rome, ishte ulur në rreshtin e parë afër një vajze që nuk ishte rome. Ato kalojnë mirë me njëra-tjetrën. Aurora ishte nxënëse e mirë, e kohë pas kohe ndihmonte edhe Alesian në kryerjen e detyrave të shtëpisë. Një ditë, nëna e Aurorës erdhi në klasë. Ajo foli me mësuesin duke thënë që mjetet mësimore të vajzës së saj po mungonin dhe që i kishte humbur në klasë. Mësuesi i tha Alesias që të shkonte në rreshtin e fundit, si dhe vendosi një djalë jo-rom afër Aurorës.

Rasti V

Prindërit romë që jetojnë në një lagje rome afër hekurudhës dëshirojnë ta regjistrojnë vajzën e tyre në shkollë fillore. Ata shkuan në shkollën e afërt me lagjen e tyre për ta regjistruar. Asistenti i drejtorit iu tha të sillnin certifikatën e lindjes dhe librezën e imunizimit të vajzës së tyre.

Pas dy ditësh, prindërit shkuan prapë në shkollë, me dokumentet e kërkuara, por asistenti iu tha që nuk kishte më hapësirë në klasa për fëmijë të tjerë, si dhe që ata duhet të shkonin në një shkollë tjetër që është në anën tjetër të hekurudhës. Ata i thanë asistentit që nuk mund ta regjistrojnë vajzën në shkollën tjetër, sepse frikësohen se asaj do t'i duhej të kalonte hekurudhën e vetme për çdo ditë. Ata punojnë me shitje të rrobave të dorës së dytë në fshatrat e afërt, si dhe nuk mund ta përcjellin deri në shkollë.

Rasti VI

Ronaldi është dhjetëvjeçar. Ai është i vetmi nxënës rom në klasë. Një ditë, mësuesi erdhi në klasë dhe kërkoi nga klasa që të ngrenë dorën ata që janë romë, sepse shkolla do t'u japë, librat shkollorë pa pagesë, pasi janë të varfër. Ronaldi nuk kishte zbuluar përkatësinë e tij etnike deri atëherë dhe nuk e ngriti dorën, sepse frikësohej se të tjerët do ta trajtonin ndryshe. Ai as nuk foli me prindërit për këtë, sepse frikësohej që do ta qortonin. Megjithatë, Ronaldi është i vetëdijshëm që prindërit e tij kanë probleme financiare.

Rasti VII

Shumë prej fëmijëve romë jetojnë në periferi të Tiranës, pranë lumit dhe nuk e frekuentojnë shkollën, pasi shkojnë bashkë me prindërit të punojnë (mbledhin materiale të riciklueshme). Skënderi, një baba rom në moshë të re, dëshiron që fëmijët e tij të shkollohen. Çdo ditë i shoqëron fëmijët në shkollë me një mjet të sajuar dhe më pas shkon të mbledhë kanaçe dhe skrap. Kur vjen ora e mbarimit të shkollës, ai vjen dhe i merr. Një ditë, kur shkoi si zakonisht të merrte fëmijët nga shkolla dhe ata i thanë se nuk donin të shkonin më në shkollë. Drejtoresha i kishte çuar te banjot e shkollës dhe i kishte çuar në banjo dhe u kishte thënë të lahashin para se të hynin në klasë. Nxënësit e tjerë i kishin përqeshur.

Kur foli me drejtoreshën, ajo i tha se donte t'i ndihmonte fëmijët pasi familja nuk ka kushtet e duhura për t'i sjellë fëmijët të pastër në shkollë. Ajo u shpreh se donte që ata të ndiheshin mirë. Fëmijët e tjerë nuk duan të shoqërohen me ta sepse "mbajnë erë".

Shotjca 2

Modul i fokusuar tek romët



Përgatitur nga: Marsela Taho

Marsela punon për Fondin për Arsimimin e Romëve qysh prej tre vitesh, si lehtësuese për Shqipërinë dhe Kosovën. Ajo është diplomuar në punë sociale në vitin 2001, si dhe ka kryer Programin për Pjesëmarrjen e Romëve në Universitetin e Evropës Qendrore në Budapest, në dhjetor 2005. Marsela ka punuar me fëmijët dhe familjet e tyre si punonjëse sociale për organizata të ndryshme si Terres Des Homes, Programin për Qeverisjen Lokale të PNUD, AiBi (Miqte për Fëmijët) dhe Qendrën për Zhvillimin e Grave Rome. Ajo është e përfshirë në çështjet e grave rome dhe është pjesë e Rrjetit Ndërkombëtar të Grave Rome. Gjatë pesë viteve të fundit Marsela ka punuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në Tiranë, pranë Sekretariatit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve.

Moduli I: Identiteti dhe kultura

Arsyetimi: Shpesh thuhet se “kultura është karakteristikë e një grupi të veçantë njerëzish që definohet nga çdo gjë, duke filluar nga gjuha, feja, mënyra e gatimit, zakonet shoqërore, muzika dhe arti¹²”.

Megjithatë, autoritete shtetërore luajnë një rol jetik në dokumentimin dhe institucionalizimin e trashëgimisë kulturore të një kombi të veçantë, si dhe në ruajtjen e atyre tipareve që konsiderohen të shëndosha dhe në interesin më të mirë të atij kombi. Në këtë proces, shumë zakone shoqërore jo të shëndosha dënohen ose thjeshtë konsiderohen se nuk i përfaqësojnë vlerat dhe normat e shoqërisë së sotme. Kjo vlen për të thënë se kultura është më komplekse se pikëpamjet e individëve të zakonshëm që i përkasin asaj kulture dhe është mjaftë e formësuar nën kujdesin e institucioneve kulturore të udhëhequra nga shteti dhe thellësisht të ndikuara nga fakti se si e gjykojnë kulturat e tjera. Si rezultat i mospasjes së një shteti amë me institucione që e dokumentojnë dhe pastrojnë kulturën rome, duke qenë të paragjykuar, jo shumë të shkolluar dhe pak të shërbyer në vendet ku janë të vendosur, disa komunitete rome ende i ruajnë ca zakone shoqërore ‘primitive’ (më saktë, martesë të hershme, organizimi në familje të mëdha, etj.) Këto zakone shoqërore nuk janë të trashëguara në ndonjë grup të caktuar etnik, qoftë ky rom ose tjetër, dhe kanë qenë të pranishme gati në çdo shoqëri, në kohëra dhe periudha të ndryshme të zhvillimit të tyre. Autoritetet e shkollës dhe mësuesit kanë një rol thelbësor në dinamikën dhe zhvillimin e një kulture të caktuar si dhe për ndërtimin e urave lidhëse, respektit të ndërsjellë dhe shkëmbimit ndërkulturor ndërmjet fëmijëve dhe prindërve të kulturave të ndryshme brenda komunitetit shkollor.¹³

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të mësohet bërja e dallimit ndërmjet trashëgimisë kulturore rome dhe atyre manifestimeve primitive dhe të detyruara dhe zakoneve shoqërore që rrjedhin nga përjashtimi shoqërorë shumëvjeçar dhe analfabetizmi;
- Të çmohet dhe inkurajohet diversiteti dhe ndërkulturalizmi nëpër shkolla

Mjetet e nevojshme: letra të vogla ngjitëse, marker (shënues), letra të bardha

Koha: 45 min

Udhëzime:

Kohëzgjatja: 10 min

12 Çfarë është kultura? Përkufizimi i kulturës, K. A. Zimmermann 2012

13 Punim i pa publikuar, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri, B.Taho 2013

1. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm:
 - a. Pyetini pjesëmarrësit si vijon:
 - Çka është kultura;
 - A përfshihet në të vetëm e vërteta, apo edhe mitet;
 - Kush vendos se cilat elemente, të vërteta apo mite, janë pjesë e një kulture të caktuar (p.sh. autoritetet shtetërore, personat e zakonshëm, organizatat e shoqërisë civile që i përkasin asaj kulture, elita ose të tjerë që i përkasin një kulture tjetër);
 - Çfarë mund të bëjnë autoritetet arsimore dhe mësuesit për të promovuar një mjedis ndërkulturor në shkolla (p.sh. shpjegim i drejtë për romët ose kulturat e tjera pakicë në tekste shkollore, organizim i aktiviteteve që promovojnë barazi kulturore ndërmjet fëmijëve dhe prindërve me historik të ndryshëm kulturor)
 - b. Përmbyllni shtjellimin e ideve duke i theksuar argumentet e siguruar në arsyetim.

Kohëzgjatja: 15 min

2. Kërkoni nga pjesëmarrësit që, në fletë të veçanta të vogla ngjitëse, të shkruajnë elementët, mite ose të vërteta, për të cilët besojnë dhe/ose kanë dëgjuar nga të tjerët (p.sh. elita rome, persona të zakonshëm romë, etj., ose lexuar në libra) që i përkasin kulturës rome ose ndonjë kulture tjetër pakicë, e pastaj t'i grupojnë ato elemente në dy kolona, përkatësisht:
 - Të vërtetat dhe mitet që i përkasin kulturës rome ose kulturës së një grupi tjetër pakicë; dhe
 - Zakonet e detyruara shoqërore/mënyra e jetesës si rrjedhojë e përjashtimit social dhe analfabetizmit (nuk është e trashëguar në ndonjë kulturë të caktuar).

Shënim: Disa elemente të kulturës rome të perceptuar gabimisht janë martesat e hershme, mbajtja e një familjeje të madhe, mosvlerësimi i shkollimit, jetesa në kasolle afër lumenjve, etj.

Kohëzgjatja: 20 min


3. Ndajini pjesëmarrësit në grupe në mënyrë që çdo grup i vogël të shqyrtojë një (ose disa) nga elementet e identifikuar.


Çdo grup duhet të diskutoj për pyetjet vijuese:

- Si mund ta dini që një praktikë e tillë (e vërtetë ose mit) i përket kulturës rome apo grupeve të tjera pakicë?
- A ka njerëz apo grupe të tjera njerëzish për të cilët mund të thuhet se kjo gjë është e vërtetë, ose ku kjo praktikë ekziston?
- Pse mund të arrihet deri tek një situatë e tillë/Cili është shkaku që ekziston ky mit/e vërtetë?
- A konsiderohet një praktikë e tillë në literaturë, tekste shkollore, nga organizata të romëve dhe/ose elita rome si praktikë që i përket kulturës rome? A do të duhej patjetër që individë të zakonshëm romë të pajtohen me këtë?;
- A do të duhej promovuar kjo praktikë si kulturë rome, ndonëse kundërshtohet nga elita rome, ose a do të duhej që në mënyrë alternative të quhet zakon i detyruar shoqëror që rezulton nga [përjashtimi] shoqëror shumëvjeçar dhe analfabetizmi?;

Zbulimi i kulturës rome

MODELI AJSBERG I KULTURËS





Arsyetimi: Shpesh, kultura krahasohet me një ajsberg, i cili ka pjesën e dukshme dhe atë të padukshme. Elementët e kulturës, të cilat i shohim hapur në aktivitetet e shfaqura (që i bëjmë), përfaqësohen nga pjesa e sipërme (maja) e ajsbergut. Ato elementë që nuk janë aq të dukshëm, siç janë mendimi dhe ndjenjat, përfaqësohen nga pjesa më e madhe e ajsbergut nën ujë.

Kur shihet në ujë, afërsisht vetëm 10% e ajsbergut mund të shihet – pjesa më e madhe e tij është nën sipërfaqe të ujit. Ky model¹⁴ është i dobishëm për të na ndihmuar t'i kuptojmë sjelljet e anëtarëve të kulturave të tjera.

Disa autorë¹⁵ kanë sugjeruar rrotullimin e modelit të ajsbergut me kokë poshtë¹⁶ dhe që niveli nën ujë të emërohet *cilësitë që na bëjnë njerëz*. Këta autorë, më tej, sugjerojnë që duke filluar me cilësitë njerëzore, gjetjen e të përbashkëtave, ne mund të afrohem dhe lidhemi me njerëz të kulturave të ndryshme.

14 Përshtatur nga Guy Rocher, 'Introduction a la sociologia generale', Tome 1, 1969 siç prezantohet nga Qendra për Nxënie Ndërkulturore në Institutin Kanadez për Shërbime të Jashtme 2010.

15 Prezantim nga Ruth Van Reken në konferencën e IBAP, siç citohet në blogun 'What Ed Said', nën majën e ajsbergut, 2012, at <http://whatedsaid.wordpress.com/2010/06/13/below-the-tip-of-the-iceberg>

16 Përshtatur nga blogu 'What Ed Said', nën majën e ajsbergut, 2010 në <http://whatedsaid.wordpress.com/2010/06/13/below-the-tip-of-the-iceberg/>

Umjesto da se fokusiramo samo na vrh ledenog brijega potrebno je da ovakvo razmišljanje postavimo za cilj podučavanja i učenja o drugim kulturama.

Në vend që të fokusohemi vetëm në majën e ajsbergut, ne duhet ta shndërrojmë këtë lloj të kutpuari në qëllim tonin në mësimdhënie dhe mësimnxënie për kultura të tjera.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Të nxitet interesimi i pjesëmarrësve për të mësuar rreth kulturave të tjera, përfshirë kulturën rome;
- Të ndihmohen pjesëmarrësit të gjejnë mënyra për të ndërvepruar dhe për t'u lidhur me njerëz të kulturave të ndryshme;

Mjetet e nevojshme: letra të vogla ngjitëse, marker (shënues), letra të bardha

Kohëzgjatja: 30 min

Udhëzime:

1. Ndani pjesëmarrësit në grupe sipas kombësisë;
2. Kërkoni nga secili grup që të identifikojë sa më shumë elemente të çdo kulture dhe grupojini ato në kategori të dukshme dhe të fshehura, ashtu siç duket më e përshtatshme;
3. Kërkoni nga çdo grup ta prezantojë punën duke theksuar se çfarë është e dukshme e çfarë e padukshme në atë kulturë për njerëzit që u përkasin kulturave tjera;
4. Kërkoni nga të gjithë pjesëmarrësit të identifikojnë elementet e përbashkëta të kulturave të ndryshme dhe vazhdojeni këtë me diskutime për mënyrën se si mund të shfrytëzohen elementet e përbashkëta dhe të dallueshme për shkëmbime të vazhdueshme kulturore;

Moduli II: Përfshirja e prindërve dhe fëmijëve Romë

Arsyetimi: Prindërit kanë ndikim të madh në veprimet, të menduarit dhe ndjenjat e fëmijëve, si dhe në mënyrën se si fëmijët e tyre e perceptojnë si kulturën e tyre dhe atë të njerëzve të tjerë. Edukimi ndërkulturor, ku vlerësohet veçantia e secilit fëmijë, kërkon pjesëmarrjen e prindërve nga kultura të ndryshme në këshillat e prindërve nëpër shkollë¹⁷. Nevojitet një ndërveprim i ndërsjellë mes prindërve nga kultura të ndryshme, siç sugjeron edhe loja “Muri i familjes”¹⁸.

Rezultatet e mësimnxënies:

- Mësimi për vlerat familjare dhe të komunitetit si dhe kulturat;
- Inkurajimi i vlerësimit të veçantisë së çdo kulture dhe shkëmbimit ndërkulturor

Mjetet e nevojshme: fotografi nga jeta, familja dhe komuniteti i fëmijës

Kohëzgjatja: 30 min

Udhëzime:

1. Ndërtoni një mur të familjes në klasë; Kërkoni nga mësimdhënësit që të sjellin nga tre fotografi që përfaqësojnë jetën, familjen dhe komunitetin e fëmijës.
2. Përdoreni këtë mur dhe fotografitë për të filluar biseda me fëmijët rreth jetës dhe familjeve të tyre; organizoni aktivitete të tilla që të gjithë fëmijët të mund të shohin, dëgjojnë dhe bëjnë pyetje njëri-tjetrit.
3. Përdoreni këtë mur për të treguar se sa çmohet veçantia e çdo fëmije; flisni me fëmijët rreth gjërave të përbashkëta që shohin, si dhe dallimet që ekzistojnë ndërmjet tyre.
4. Sillni fotografi të familjes suaj dhe tregojani fëmijëve.

17 Pjesëmarrja e prindërve romë në këshillat shkollore duhet të promovohet nga autoritetet shkollore dhe mësimdhënësit. Në këtë drejtim, autoritetet shkollore mund të organizojnë që mësimdhënësit dhe prindër jo-romë të bashkohen në çifte dhe të bëjnë vizita nëpër shtëpi dhe të diskutojnë me prindër romë për rolin e tyre në këshillat e prindërve. Organizimi i ngjarjeve sociale (art, kulturë, argëtim, sport) me përfshirje të prindërve romë dhe jo-romë të kulturave të ndryshme gjithashtu do të krijonte ura lidhëse. Të bësh që prindërit romë të ndihen të vlerësuar në mënyrë të barabartë është e rëndësishme së madhe për të fituar besimin e tyre dhe përkushtimin për t'u bërë anëtarë aktivë të këshillave të prindërve. Nëse në mesin e anëtarëve jo-romë të këshillave të prindërve ka persona të dalluar e personalitete të njohura publike nga fusha e artit dhe kulturës, mediave, etj., atyre do të duhej të ju caktohet misioni i inkurajimit dhe përkrahjes së prindërve të fëmijëve nga kulturat pakicë, duke përfshirë atë romë. Përfshirja e prindërve romë të zotë, udhëheqësve dhe individëve të tjerë të suksesshëm do të sjellë ndikim pozitiv.

18 Loja e Murit të Familjes është përshtatur nga: Udhëzues i Mësimdhënësit për Praktika të Mira në Shërbimet Përfshirëse të Fëmijërisë së Hershme, *Fuqishëm që në fillim*: Ndërtimi i mundësive të fëmijërisë së hershme, Zorica Trikić, *zhvilluar me përkrahje të Komisionit Evropian, bashkërenduar nga Fondi për Edukim të Romëve në partneritet me Asociacionin Ndërkombëtar 'Hap pas Hapi'*.

Sugjerime se si të reagohet në situata sfiduese

- a. Prindërit e fëmijëve nga komuniteti shumicë ankohen se mësuesi ua ka ulur djalin afër një nxënësi rom në klasë, duke kërkuar nga mësuesi që t'ia ndërrojë vendin djaloshit rom**

Rregulloret e shkollave që promovojnë respekt për diversitet kulturor

Rregulloret e brendshme të shkollave duhet të përmbajnë nene që udhëhiqen nga parimet e luftimit të diskriminimit, vlerësimit të diversitetit kulturor, si dhe komunikimit etik. Në situatën konkrete, prindërit nuk mund të bëjnë një kërkesë të tillë thjesht dhe vetëm për shkak të origjinës romë të shokut të klasës së djalit të tyre. Me përjashtim të rasteve kur kërkesa vjen si rezultat i sjelljes problematike të fëmijës, autoritetet e shkollës nuk duhet të merren me atë. Për më tepër, edhe nëse kërkesa vjen si rezultat i sjelljes problematike të fëmijës rom, ajo duhet të formulohet në mënyrë të tillë që nuk paragjykon askënd dhe duhet të jetë në pajtim të plotë me komunikimin etik.

- b. Gjatë orëve të mësimit, një fëmijë nga komuniteti shumicë i drejtohet shokut të tij të klasës rom me nofka që zakonisht nënkuptojnë inferioritet (p.sh. jevg ose emra të tjerë lokalë, në vend të rom“);**

E drejta për emër dhe kombësi

E drejta për emër dhe kombësi është e mishëruar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Respektimi i kësaj të drejte nënkupton që personat duhet t'ju drejtohet të tjerëve në emrin e zgjedhur nga këta të fundit. Prandaj, mësuesit duhet t'ua sqarojnë këto të drejta fëmijëve dhe t'u kërkojnë që ta respektojnë emrin dhe përkatësinë kulturore të njëri-tjetrit. Kjo çështje duhet, gjithashtu, të adresohet në komunikimin e kodit të etikës. Në rastin konkret, autoritetet e shkollës, në konsultim me organizatat romë (apo të tjera të pakicave) ose institucionet që ofrojnë mbrojtje për pakicat, duhet të njihen me emrat zyrtarë të pakicës dhe t'u japin udhëzime përkatëse mësuesve, prindërve dhe fëmijëve të kulturave të ndryshme. Në rregulloren e brendshme të shkollës mund të parashikohen masa disiplinore për ata që e shkelin atë.

- c. Prindi (rom ose jo) e ndalon vajzën të frekuentojë arsimin e detyrueshëm me arsyetimin se ajo është gati për t'u martuar;**

Sfidimi i perceptimit se martesat e hershme janë pjesë e kulturës romë:

Disa romë (dhe grupe të tjera pakicë) janë analfabetë dhe shpesh të izoluar nga pjesa tjetër e shoqërisë apo njerëzve, duke jetuar në kushte të rënda dhe në familje shumë të mëdha. Në rrethana të tilla, prindërit e këtyre familjeve nuk janë në gjendje t'u sigurojnë shkollim fëmijëve, të cilët duhet të fillojnë një jetë të pavarur duke punuar ose krijuar familjen e tyre në moshë të hershme. Kjo ndodh sepse, në rrethanat aktuale, shkollimi nuk është një zgjedhje e mundshme ose me përfitime. Kushdo qoftë dhe nga çfarëdo prejardhje qoftë, përballë një situatë të tillë jetësore, me shumë

gjasë do të reagojnë në mënyrë të ngjashme pavarësisht nga përkatësia etnike. Më e rëndësishmja, mungesa e institucioneve të kulturës rome që dokumentojnë dhe institucionalizojnë trashëgiminë kulturore rome kanë lënë vend për paragjykime me perceptimin se mënyra e tillë e jetesës dhe sjellja jo e shëndoshë shoqërore është pjesë e kulturës së romëve.

Mendo për veprime administrative:

- Diskutojeni fenomenin në këshillat e prindërve dhe planifikoni një sërë veprimesh;
- Autoritetet e shkollës dhe përfaqësuesit e këshillave të prindërve të krijojnë një *'task-force'* të përbashkët në bashkëpunim me organizatat lokale rome në lidhje me frekuentimin e shkollës;
- Të përgatiten fletushka informuese dhe fushata ndërgjegjësuese për përgjegjësinë e prindërve sa i përket vijimit të mësimit dhe shkollimit të detyrueshëm për fëmijët e tyre;
- Të përfshihen prindërit dhe fëmijët, të cilët ka gjasë të braktisin shkollën, në ngjarje shoqërore të shkollës me qëllim forcimin e vlerësimit të tyre për shkollën.

